



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 25 QERSHOR 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 25. JUNA 2010. GODINE

QERSHOR – JUNI
2010

E premte, më 25 qershor 2010, ora 10:00

Drejtton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Unë ju kam njoftuar, është dashur t'i bihet ziles 5 minuta në 10:00. Administratë, kryeni detyrën tuaj! Ne vazhdojmë, do të thotë, kemi 30 minuta. Deputetët duhet të mësohen të vijnë me kohë në sallë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka deputeti Driton Tali. Nuk është këtu.

Mimoza Ahmetaj e ka fjalën!

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Të nderuar deputetë,

Dy javë më parë, Departamenti i Shtetit Amerikan publikoi Raportin vjetor për trafikimin e qenieve njerëzore, në të cilin paraqitet gjendja e përgjithshme e trafikimit të qenieve njerëzore në botë dhe që me këtë mundohet që t'iu ndihmojë qeverive të shteteve në hartimin e strategjive kundër trafikimit. Në këtë raport përfshihet edhe Kosova. Raporti rëndit shtetet në tri nivele apo Tër, Kosova në këtë rangim renditet e dyta, ngjashëm me të gjitha shtetet fqinje si dhe shumë shtete të regjionit, disa nga të cilat janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s. Nga ajo që u dha në mediat e shkruara dhe elektronike, situata paraqitet mjaft kritike, gjë e cila nxiti interesim të madh në publik. Në mënyrë që raporti të kuptohet sa më qartë nga opinionin publik, mendoj se duhet të plotësohet edhe me argumente të tjera relevante dhe specifike për Kosovën, që jo shumë u bënë të njohura nga mediat e që në masë të madhe ndikojnë luftimin e kësaj dukurie.

E para, Kosova nuk ka regjim të vizave për shtetasit e huaj, prandaj është e pamundur të bëhet ndalimi dhe dëbimi i personave që dëshirojnë të hyjnë në Kosovë ose kalojnë transit nëpër të.

E dyta, Kosova nuk është anëtare e Jupilolit ose Interpolit, prandaj paraqiten vështirësi në shkëmbimin e informatave të nevojshme në lidhje me personat e involvuar në trafikimin që janë në evidenca të këtyre institucioneve.

E treta, policia kufitare e Kosovës së voni i ka marrë kompetencat të bëjë kontrollin e plotë në një nga vendkalimet kufitare. Njësitit antitrafikim pranë Policisë së Kosovës edhe pse me përvojë të limituar dhe me tendencë në ngritje të kapaciteteve profesionale, përmes trajnimeve të ndryshme i duhet përkrahje më të madhe deri në arritjen e rezultateve të dëshirueshme, gjë të cilën Qeveria është e përkushtuar ta bëjë.

Është për t'u veçuar edhe një fenomen tjetër që në shumë shtete të botës, përveç personave të trafikuar për prostitucion ka edhe të tillë që trafikohen për punë në bujqësi ose në amvisëri, gjë e cila në Kosovë nuk haset ose është shumë e rrallë. Cilat janë masat e ndërmarra deri tani? Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për të huajt dhe Ligjin për punësimin e shtetasve të huaj. Këto ligje, në mes shumë çështjeve tjera, kanë edhe një qëllim që të vënë në kontroll hyrjet e shtetasve të huaj në Kosovë dhe veprimtarinë e tyre gjatë qëndrimit brenda, në mënyrë që sado pak të kemi kontroll mbi qarkullimin e shtetasve të huaj. Qeveria ka ndarë mjete për strehimoret, që në Kosovë llogariten të jenë 6, gjithsej. Ministria e Arsimit ka organizuar takime nëpër shkolla dhe ka shpërndarë broshura për t'i informuar fëmijët, pedagogët dhe prindërit rreth këtij fenomeni si dhe për të sensibilizuar popullatën

për këtë dukuri. Sistemi prokurorial dhe gjykatat janë në angazhim të plotë kur bëhet fjalë për këtë çështje, ata vazhdimisht vijojnë trajnime për trafikim, në mënyrë që ta kenë më të qartë këtë dukuri dhe rëndësinë e saj. Pajtohem që një numër i të dënuarve...

KRYETARI: Faleminderit!

Armend Zemaj e ka fjalën. A e kemi këtu Armendin? Mungon.

Atëherë, fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Para disa ditësh menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës u zotua që në vitin e ardhshëm akademik, do të thotë, në vitin 2010-2011, do të regjistrojë mbi 18 mijë studentë të rinj, madje ky numër paraqet numër më të madh se sa që është numri i nxënësve që kanë mundur të kalojnë testin e maturës, i cili numër mund të arrijë deri në 16 mijë. Në realitet numri i studentëve për të cilin është zotuar menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës, paraqet dyfishin e numrit të studentëve që fakultetet kanë kërkuar për regjistrim. Natyrisht që nuk jemi kundër shkollimit të rinjve tanë, por duhet të dimë që për shkollim duhet të krijohen kushtet adekuate në mënyrë që të kemi cilësi.

Rritja e numrit të studentëve kërkon edhe rritje të hapësirës, por edhe rritje të stafit. Tani për tani këto mundësi e dimë që nuk i kemi dhe fakultetet që kanë numër më të madh të studentëve ballafaqohen pikërisht me këto probleme.

Në Fakultetin Ekonomik një studenti i takon hapësirë vetëm prej 20 centimetra, ndërsa një mësuesi punon me numër të madh të studentëve, që arrin edhe deri në disa qindra.

A do të mund të sigurohen kushte të nevojshme për gjithë këtë numër të studentëve brenda një afati kaq të shkurtër për vitin e ri akademik? Pra, kjo paraqet një problem. Dhe mbi të gjitha tanimë, përveç që kujdesemi për shtimin e numrit të studentëve, është koha t'i kushtojmë rëndësi edhe më të madhe cilësisë së kuadrove që ne i përgatisim dhe për këtë duhet të krijohen kushte. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Unë personalisht jam që gjithë ata që donë për t'u regjistruar, le të regjistrohen, për të mos krijuar defekte tjera.

Fjalën e ka deputeti Basri Musmurati.

BASRI MUSMURATI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më 28 maj të këtij viti, pata shtruar pyetje për ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe Sportit, zotin Lutfi Haziri, lidhur me gjendjen momentale të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës. Pasi deri më sot nuk mora asnjë përgjigje, jam i detyruar që këtë çështje ta shtroj sot në këtë seancë plenare, jo vetëm si shqetësim timin personal për gjendjen e rëndë dhe kujdesin e pamjaftueshëm të institucioneve për këto monumente, por më tepër si një kërkesë që institucionet përkatëse të veprojnë sipas ligjit në fuqi, për ruajtjen e tyre.

Pjesa dërmuese e monumenteve të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës janë në gjendje të rëndë, por ajo që është edhe më shqetësuese është fakti se një pjesë e tyre ose po rrënohen ose po përvetësohen nga persona të pandërgjegjshëm, bile shpesh edhe me bekimin e njerëzve përgjegjës të institucioneve. Rasti më i freskët është ai rrënimit të Xhamisë Hatunie në qendër të Prishtinës, e cila

daton nga shekulli XI dhe i hotelit Union, po ashtu në qendër të Prishtinës, i cili daton që nga fillimi i shekullit XX. Këto dy monumente janë ndërtime të trashëguara ndër breza dhe njësi integrale në zonën historike të Prishtinës, të cilat bartin vlera historike, shoqërore, mjedisore dhe njëherësh janë dëshmi materiale të zhvillimit historik dhe të identitetit të vendit tonë. Si trashëgimi arkitekturore ato janë një pasuri e paktestueshme e një rëndësie nacionale si dhe të një interesi publik.

Rrënimi i plotë i Xhamisë Hatunie dhe gati shkatërrimi total i hotel Unionit, janë rrjedhojë e planeve dhe lejeve joprofesional, madje edhe i vendimmarrjeve arbitrare e kundërligjore të organeve jo kompetente. Veprimet e këtilla kundërligjshme jo vetëm që po rrezikojnë zhdukjen e trashëgimisë tonë kulturore, por njëherësh po krijojnë perceptime tepër negative për institucionet e vendit lidhur me funksionimin e shtetit ligjor.

Me këtë rast kërkoj që institucionet relevante, përkatësisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të angazhohen më shumë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kësaj trashëgimie edhe ashtu të paktë të vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi e ka fjalën.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar, kolegë deputetë,

Dua të ngre një çështje e cila njëkohësisht përbën shqetësim në vete për gjithë ne dhe institucionin e Kuvendit. Konstatimet që në vijimësi i kanë ngritur përfaqësuesit e opozitës për marginalizimin e Kuvendit, për fat të keq të Kosovës janë rikonstatuar dhe konfirmuar në fjalimin e Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovës, zotit Piter Feith, ku ndërmjet tjerash, thuhet citoj: “Kuvendi mbetet në periferi të vendimmarrjes dhe shumë vendime merren vetëm në Qeveri, pa ndonjë përfshirje të rëndësishme të Kuvendit”. Rrjedhimisht, të nderuar kolegë deputetë, Kuvendi i Kosovës, përball sfidave nëpër të cilat po kalon vendi, që nuk janë dhe nuk do të jenë aspak të lehta si zbatimi i kushtetutshmërisë në gjithë territorin e vendit, bisedimet me Serbinë, lufta kundër korrupsionit dhe marrëdhëniet diplomatike të vendit në nivel bilateral dhe multilateralë, duhet ta ngre rolin e vet.

Nëse indolencia e Kuvendit është justifikuar me mungesë të kapaciteteve, unë mendoj të kundërtën. Legjislativi ka më shumë kapacitete profesionale dhe ekspertizë se sa ekzekutivi i vendit, por për më tepër Kuvendi ka shumë më shumë legjitimitet dhe kredibilitet qytetar në përballje me këto preokupime madhore se sa segmentet qeveritar.

Sa i përket shtrirjes, përkatësisht mos shtrirjes kushtetutshmërisë në gjithë territorin dhe zgjidhjes së problemit të pjesës veriore të Mitrovicës, Qeveria ka promovuar kohë më parë një strategji për të cilën ky Kuvend nuk është konsultuar as informuar dhe për më tepër tash e disa muaj nuk ka asnjë lloj raporti se ku ndodhet Qeveria me implementimin e saj.

Ndërkaq lidhur me bisedimet e paralajmëruara tashmë me Serbinë, që do të fillojnë pas deklaramentit të mendimit të GJND-së, serish ndajmë shqetësimin se Kuvendi po mbahet larg informimit mbi përmbajtjet dhe formatin e këtyre bisedimeve. Sipas mendimit tonë, Kuvendi është institucioni që ka aprovuar Kushtetutën dhe dokumentin Ahtisari, i cili i jep zgjidhje problemit të serbëve në Kosovës përgjithësisht dhe atyre në veri në veçanti. Rrjedhimisht, Kuvendi i Kosovës, i vetmi ka legjitimitet qytetar, që eventualisht të bisedojë për problemet teknike dhe pragmatike në marrëdhëniet Kosovë – Serbi.

Pretendimet e Qeverisë se ata do të jenë në krye të luftës kundër korrupsionit, nuk tingëllojnë shumë kredibile nëse ky Parlament mbetet vëzhgues i largët dhe pasiv në këtë proces tepër sfidues.

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua t'ju rikujtoj se gjithë mekanizmat institucional për luftimin e korrupsionit janë ndërtuar nga ky Kuvend dhe i subordinohen atij, andaj, Qeveria do të duhej të inkurajonte Kuvendin dhe natyrisht organet e drejtësisë të merreshin me këtë.

Në fund përmenda rolin që Kuvendi i Kosovës duhet të ketë në marrëdhëniet e Kosovës me jashtë, si në planin dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh.

Dua të përmend vetëm një fakt shqetësues kur Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës lidhur me çështjen e ekstradimit i referohet një marrëveshje amerikano – serbe të vitit 1901, në vend që të draftojë një marrëveshje të re dhe ta sjellë në Parlament për ratifikim.

Të nderuar deputetë,

Ironia e kësaj deklarate është aq e madhe sa nuk e pranojnë as filloristët. Në vitin 1901, Kosova nuk kishte asnjë lloj varësie dhe nuk ishte pjesë e Mbretërisë së Serbisë. Të gjitha këto momente që i zura në gojë, flasin për prepotencën e Qeverisë përball impotencës së Kuvendit, duke krijuar shpeshherë përshtypjen në opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për ndërrim të roleve dhe për një mungesë të demokracisë parlamentare në një vend që veten e ka shpallur Republikë parlamentare.

Ndaj, të nderuar kolegë, nga pozita edhe opozita, ju ftoj që të reflektojmë përgjegjësi maksimale përball misionit tonë përfaqësues që kemi dhe veten ta shohim si rregullator të funksionimit të jetës institucionale në shtetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Opinionin kosovar dhe qytetarët e vendit tonë janë të shqetësuar lidhur me cenimin e sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë.

Hyrja e një grupi të konsiderueshëm të ashtuquajtur garda, organizata dhe institucione paralele, për të cilët e dimë çka kanë vepruar dhe çka mendojnë për Kosovën dhe vendin tonë, në territorin e shtetit tonë, pa përfillur pikën kufitare, pa procedura dhe duke shpërfillur policinë tonë dhe policinë e EULEKS-it, nuk mund të quhet ndryshe, përpos falimentim institucional, shkelje e rëndë e Kushtetutës, shpërfillje dhe poshtërim i shtetit të Kosovës, sovranitetit, integritetit territorial dhe kushtetutshmërisë së vendit tonë. Këto akte janë fyerje të rënda për qytetarët e Kosovës, kur kjo bëhet ditën dhe me grupe të tilla që dihet se çka mendojnë dhe veprojnë për vendin tonë, çka ndodh natën, çka ndodh me kontrabandën e mallrave, krimin e organizuar dhe ekonominë informale që po e fundos perspektivën e këtij vendi? A ka ky vend institucione dhe Qeveri, për kënd dhe kujt i shërben kjo Qeveri? Pra, kjo është pyetje që ne si deputetë, njerëz të zgjedhur duhet t'ia bëjmë vetvetes, sepse Qeveria si duket e ka humbur rrugën. Çfarë duhet të bëjë Kuvendi lidhur me këtë, duke e parë se çfarë Qeverie e papërgjegjshme që merret vetëm me punën personale të klaneve, të grupeve të individëve dhe shkatërrimin e institucioneve në vend që t'i ndërtojë ato. Edhe miqtë tanë më të mëdhenj po na thonë ditëve të fundit se në Kosovë është rrezik të bëhet biznes, nuk ka investime dhe vendi dita - ditës po getoizohet dhe karantinizohet, qytetarët po privohen nga e drejta për mirëqene dhe prosperitet, deri

kur më kështu? Mbase koalicionit qeverisës mund t'i duket jo e rëndësishme dhe humor kjo çështje, por kur hynë grupet e caktuara me mision të caktuara pa e pyetur askënd, s'di pse ulen këtu dhe çfarë bëni.

Kërkesa jonë është që kjo Qeveri të këndellet më në fund kundrejt problemeve jetike që i ka shteti dhe populli jonë, të merret seriozisht me ruajtjen dhe ndërtimin e shtetësisë që e keni obligim kushtetues dhe përgjegjësi para qytetarëve të vendit, se po merreni vetëm me çështje terciare, tenderomani dhe paraqitje triviale duke tentuar të blini kohë dhe poenë politik që gjithmonë në fund faturën më të shtrenjtë po e paguan qytetari i Kosovës. Kjo nuk është qeverisje, unë nuk di si keni fytyrë të dilni para popullit, para mediave dhe të flisni futurizëm dhe fontanë dëshirash. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje,

Unë në kuadër të kësaj teme po ritheksoj nevojën e një debati në këtë Parlament, të përgatitur nga Qeveria dhe koalicioni lidhur me dy projektet nacionale që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe financimin e autostradës dhe iniciativa për privatizimin e Postë - Telekomit të Kosovës. Mendoj që kjo bie dhe pajtohet plotësisht edhe me zotimet e kryeministrit se për projektet e mëdha nga ky Parlament duhet, pra t'i informojmë qytetarët me politikën tonë, me politikën e Qeverisë që të jemi sa më transparent për të realizuar në interesa të atij zhvillimi ekonomik që është synim edhe i Qeverisë edhe i joni.

Prandaj, më lejoni të theksoj që mungon, pra transparencja ose ka munguar deri më tash në shkallën e mjaftueshme nga ky Parlament për t'ju drejtuar qytetarëve lidhur me autostradën, qoftë me analizën ekonomike dhe koston që do të ndodhë për autostradën, qoftë me analizën inxhinierike dhe mundësinë e devijimit të autostradës, qoftë me mënyrën e financimit dhe futjes në borxh të vendit, të cilën pra nuk e ka sqaruar, si dhe kapacitetet e ngushta që i kemi si buxhet i Kosovës për të financuar ose alternativat më të mira për ta ndërtua autostradën. Prandaj, edhe afati kohor, në të cilën apo është paraparë dinamikën mendoj që duhet të rishqyrtohet në Parlament për arsye se ka zgjidhje më të mira. Kur jemi te kjo temë dhe pse është komplementare me çështjen e privatizimit të PTK-së, është vetë iniciativa, pra që këto dy projekte nacionale janë të ndërlidhura tani njëra me tjetrën në politikat e Qeverisë. Dhe mendoj që PTK nuk duhet në këtë fazë të privatizohet për arsye se është më mirë në alternativën tjetër, Qeveria ta menaxhojë më mirë PTK-n, e cila ka mundësi ekonomike që të afarojë pozitivisht, e cila ka mundësi pra që të krijojë profit 60 deri në 80 milionë brenda vitit, ka mundësi që të ketë investime në sektorin e telefonisë fikse, t'i rritë asetet me një performancë dhe kështu pra të ruhet si pasuri e Qeverisë. Pse duhet të ndryshohet kjo alternativë dhe ky kombinim në këto dy projekte? Mendoj që duhet, për arsye se në afat prej 5 deri 10 vjet mund që të financohet me një kredi të butë nga ky fitim prej PTK-së i gjithë ndërtimi i autostradës, të futet pra ky aset si hipotekë marrja e asaj kredie, që 10 vjetëve ose në fund 10 vjetëve të kemi edhe autostradën, të kemi edhe PTK-në si resurs, si pasuri e vendit, të njëjtën kohë pra të mos futet vendi në borxhe dhe të ruhet ky buxhet i qëndrueshëm për nevojat dhe fushat tjera.....

KRYETARI: Faleminderit deputet!

Në emër të Grupit të AAK-së, deputetja Melihate Tërmkolli e ka kërkuar fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Zoti kryetar, ju keni një alergji të pashërueshme ndaj AAK-së dhe vazhdimisht po shkelni Rregulloren e Punës, duke anashkaluar gjithmonë radhën dhe madje edhe pak më tepër se kjo.

Të paktën dola sot këtu për të sqaruar një çështje apo më mirë të them për t'i thënë 2 – 3 fjalë rreth një çështjeje e cila është ngritur para disa kohe në Parlamentin e Kosovës, ka të bëjë me regjistrimin e popullsisë ku një nga deputetët pyeti Qeverinë apo ministrinë përkatëse se si e komenton deklaratën e zotit Feith që ka kërkuar bashkëpunim me Serbinë në çështjet e regjistrimit të popullsisë dhe përgjigja e Qeverisë, e ministrisë përkatëse ishte një përgjigje e zakonshme, me fraza patriotike të shekullit të kaluar, madje duke u thirrur edhe në diploma të Harvardit se ne do ta bëjmë këtë me ndërkombëtarët.

Qeveria jonë po dëshmon se jo veç që është e korruptuar, por është edhe shumë e padijshme. Është shumë e padijshme, sepse zoti Feith e ka ditur shumë mirë çka po thotë, por Qeveria jonë nuk po mbërrin ta kuptojë ose nuk po donë ta kuptojë çfarë ka thënë zoti Feith. Në dokumentin Marrëveshja Gjithëpërfshirëse për Kosovën, në dokumentin e Ahtisarit që njihet, thuhet shumë qartë që Republika e Serbisë dhe shtetet tjera fqinje do të autorizojnë regjistrimin e popullsisë është fjala, përmes një agjencie ndërkombëtare të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, që dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Këtë e ka bërë grupi ynë i famshëm atëherë, e ka pranuar Grupi Negociator i ashtuquajtur, Grupi i Unitetit, në fakt grup i çmontimit të pavarësisë së Kosovës, dhe e kanë pranuar me lehtësinë më të madhe me lehtësinë e padurueshme që një shtet tjetër t'i regjistrojë qytetarët e shtetit tonë. Duhet t'i them Qeverisë që kjo është kundër standardeve ndërkombëtare edhe ajo që e ka thënë Ahtisari është kundër standardeve ndërkombëtare, është shkelje e standardeve ndërkombëtare, sepse qytetarët e një vendi, qofshin ata brenda, qofshin qytetarët jashtë, sipas rregullave ndërkombëtare regjistrimin e bën institucioni përkatës i vendit përkatës. Ndërsa në vendin tonë regjistrimin e qytetarëve tanë do ta bëjë dikush tjetër dhe në këtë kontekst ju i dini shumë mirë pretendimet e Serbisë që flasin diku për 500 mijë serbë të cilët kurrë nuk kanë ekzistuar në këtë numër në Kosovë, në asnjë fazë. Qeveria jonë me gjasë do që t'ia krijojë këtë mundësi edhe këtë mundësi të padrejtë dhe të paqenë. Ndoshta, Qeveria sot mund të ndihet keq, por një ditë mbase duhet të na di për nderë që së paku po ja aktualizojmë këtë çështje për t'i ndihmua që të fillojnë t'i hapin sytë dhe të punojnë seriozisht, në këtë në mënyrë që të ndryshohet kjo në funksion të respektimit të standardeve ndërkombëtare për të bërë një regjistrim të popullsisë ashtu siç bëhet në të gjitha vendet nga institucioni përkatës i vendit në fjalë, në rastin tonë nga institucionet e Kosovës.

Dhe së fundi, kjo Qeveri edhe më tutje nuk po arrin të bëjë dallimin mes regjistrimit të popullsisë edhe regjistrimit civil. Do të ishte në të mirë të Qeverisë, në të mirë të qytetarëve, në të mirë të vendit tonë, që t'ju tregohet qytetarëve, t'ju tregohet institucioneve, po ta mësojnë më së pari vetë çka është regjistrimi i popullsisë, çka është regjistrimi civil, çfarë efekte krijon njëri dhe çfarë efekte krijon tjetri? Faleminderit!

KRYETARI: Unë nuk kam kurrfarë alergjie për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, bile i kam namin do kolegë atje.

Fjalën tani e ka deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projekti i rrugës regjionale Vushtrri – Skenderaj ishte i projektuar kaherë, konkretisht në vitin 1979 dhe konsiderohej si një projekt i një rëndësie të veçantë, sepse lidhte rrafshin e Kosovës me rajonin e Drenicës, me rrafshin e Dukagjinit. Por në fakt asnjëherë nuk kishte filluar që të ndërtohet dhe për të njerëzit e asaj kohe shprehin mendime nga më të ndryshimin për mos ndërtimin e kësaj rruge.

Prandaj, lajmi për fillimin e punëve në rrugën Vushtrri – Skenderaj për të gjithë banorët e atyre fshatrave që jetojnë përgjatë kësaj rruge, ishte thuaj se një ëndërr, por në të njëjtë kohë shfaqën

entuziazmin e tyre se më në fund kjo rrugë po ndërtohet nga shteti ynë i lirë. Për të gjithë ne dhe ata banorë ishte e kuptueshme se kjo rrugë nuk do të mund të përfundonte dhe të ndërtohej brenda një viti, sepse kërkoheshin mjete të mëdha financiare. Projekti është në rrugën e mbarë të finalizimit pasi që kanë përfunduar punët në pjesë më të madhe të saj nga Novolani, Dubovci deri në Polac ka përfunduar asfaltimi. Ndërsa, rruga nga lagjja Kabashi e fshatit Polac deri në shiritin e rrugës Skenderaj – Drenas, ka mbetur ende po thuaj se po u filluar. Unë nuk e konsideroj pengesë shtëpinë e një pronari në këtë lagje, sepse vazhdimisht është sjell në mënyrë shumë korrekte dhe ka një kërkesë shumë të drejtë rreth kompensimit të shtëpisë, sepse nuk ka shtëpi tjetër të banimit.

Unë do të ngre një shqetësim të banorët e fshatit Polac, të cilët në ditët me vapë po përballen edhe me pluhurin, i cili vjen si rezultat i mjeteve të rënda të transportit, të cilët po shkojnë në këtë pjesë të rrugës së paasfaltuar.

Dhe shqetësimi tjetër apo pyetja e të gjithë atyre që qarkullojnë nëpër këtë rrugë është se kur do të përfundojë i tërë projekti, me qëllim që banorët e fshatit Polac të mos thithin pluhurin, i cili është i padëshirueshëm dhe i padurueshëm dhe lëvizja e njerëzve dhe automjeteve të bëhet e lirë, sepse pjesa e papërfunduar e rrugës u shkakton shumë telashe në qarkullim, për të mos thënë se kjo rrugë gati është e pakalueshme. Konsideroj se me qenë se i tërë Kabineti qeveritar sot është këtu, ta marrë parasysh këtë, sepse banorët e këtyre anëve shpresojnë se ky problem do të zgjidhet gjatë këtyre muajve. Faleminderit!

KRYETARI: Koha ka përfunduar për deklaratat e deputetëve, përkatësisht të grupeve parlamentare për çështjet që nuk janë në rend të ditës.

Unë jam i detyruar ta lexoj paragrafin e parë të këtij neni.

Ju lutem, ta dëgjoni me vëmendje se fjalët do t'i merrni mbi bazën e këtij paragrafi. "Në fillim të mbledhjes, para miratimit të rendit të ditës, pasi ta kenë njoftuar kryetarin e Kuvendit, deputetët, përkatësisht grupet parlamentare mund të diskutojnë për çështje të ndryshme që i konsiderojnë se duhet të bëhen publike në mbledhje plenare. Në këtë rast, një deputet nuk mund të flasë më shumë se 3 minuta, ndërsa nëse diskuton në emër të Grupit Parlamentar, mund të flasë deri në 5 minuta".

Të nderuar deputetë,

Krejt do ta lexoj, por këtë të parën ta keni parasysh.

(Reagim nga salla)

Pse po e them këtë? Është ngritur një çështje, dëgjoni ju lutem me vëmendje, se për juve është. Unë po ju them, do ta respektoj nenin 47 pikën 1 edhe për faktin se këtu është ngritur një çështje që është dashur të jetë e konsultuar me kryetarin dhe me grupet parlamentare dhe pastaj kjo çështje nga baballarët e kulturës është diskutuar jo në mënyrë kulturore, si për Kuvendin, ashtu edhe për kryetarin e Kuvendit. Jeni të obliguar të lajmëroheni deri 5 minuta në 10:00, në orën 10:00 fillon seanca dhe vazhdon kjo pikë 30 minuta, në 10:30 minuta kryhen fjalët.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

(Reagim nga salla)

Atë tjetrën lexojeni ju!

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Para se të kalojmë në rend të ditës, fjalën e ka lidhur me rendin e ditës, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Desha që në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi të ngre një shqetësim që ka ndodhur në seancën e kaluar kur është aprovuar Ligji për përgjegjësitë dhe të drejtat e deputetëve dhe pa dashje jo vetëm në Komisionin për Legjislacion, por edhe në komisionet tjera është përvjedhur një lëshim teknik në nenin 22 të pensionit suplementar dhe në vend të moshës 55 sa ka qenë në projektligjin, i cili ka kaluar edhe një herë në këtë Kuvend, është bërë gabim teknik apo lëshim teknik, është shkruar 50. Prandaj, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, kërkoj që këtë çështje Kuvendi ta rregullojë, sepse është aspekt teknik, mirëpo po ka natyrisht përfundime jo të mira.

Dhe, një çështje tjetër që natyrisht kjo lidhet me mandatin e deputetit e cila është e përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Konsultat janë bërë me shefat e grupeve parlamentare. Unë kërkoj kush është “për” korrigjimin që e tha deputeti në fjalë?

Regjia, ju lutem numëroni votat. Kush është “kundër”, ju që jeni “kundër” qoni duart pak më lart. Konstatohet se me 73 vota “për”, 2 “kundër”, miratohet propozimi i Komisionit dhe i shefave të grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 10 qershor 2010

Pyes, kush ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Faleminderit! Konstatohet se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 10 qershor 2010.

Tani kemi pikën:

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje.

Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Mungon deputeti, vazhdojmë.

Deputetja Mimoza Ahmetaj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete e ke fjalën. Edhe Mimoza mungon. Vazhdojmë.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit!

Paraprakisht mbasi veç e fillove me diskutimin për pensione mendoj se korrektja do të ishte 65 vjet si krejt të tjerët edhe deputetët të dalin pension e jo 55 vjeçar, por megjithatë po kaloj në pyetje.

I nderuar zoti ministër,

Kohë më parë në media u bë e ditur se në Ministrinë tuaj, por edhe me ministri tjera janë të punësuar shumë veta pa kontratë të punës. Pyetja është kjo: A është e vërtetë kjo, nëse po, a na tregoni si i keni punësuar këta punëtorë, në bazë të cilit ligj i punësoni dhe si i paguani?

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuar zoti deputet Tali,

Në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave nuk është i punësuar asnjë punëtor pa kontratë dhe të gjithë punëtorët janë konform Rregullores së Shërbimit Civil të Kosovës, numër 2001/36, neni 3.3. Ka pasur raste kur punëtorit nuk i është vazhduar kontrata në kohën e duhur, gjithnjë me qëllim që të bëjmë një ristrukturim konform nevojave të Ministrisë, por absolutisht asnjë punëtor pa kontratë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave nuk është dhe nuk besoj që në të ardhmen do të ketë, të paktën jo derisa unë të jem ministër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Paraprakisht, të jem zë i disa deputetëve këtu që kërkuar se ligjet nuk ndërrohen me marrëveshje, pajtohem plotësisht me ta, duhet përsëri të na sillet ai ligj. Dhe, e dyta, po e citoj Muharrem Shahinin, zëdhënësin tuaj, i nderuari ministër, ai thotë kështu, se në Ministri ka disa punëtorë të cilëve iu ka skaduar kontrata deri në 3 muaj e tjera e tjera, domethënë, megjithatë paska të punësuar me kontrata të skaduara. Si është puna e atyre, a do të shpallni konkurs apo përsëri do t'i ri punësoni ata, edhe në bazë të cilit ligj më intereson ua shtyni kontratat apo i mbani me kontrata të skaduara? Përsëri, zoti kryetar, unë insistoј në atë që thanë edhe disa deputetë, që Ligji për deputetë ose të na sillet edhe një herë ta diskutojmë ose me marrëveshje nuk mund të ndryshohet. Unë jam personalisht për 65 vjet të dalin deputetët në pension si krejt të tjerët, s'kemi pikur prej qielli ne.

KRYETARI: Është votuar, pra u krye.

MINISTRI AHMET SHALA: Zoti deputet Tali,
Skadimi i kontratës nuk do të thotë punëtor i pa kontratë. Në bazë të Rregullores së shërbyesve civilë çdo punëtori të cilit i skadon kontrata, në qoftë se nuk ka njoftim 30 ditë përpara, i vazhdohet kontrata automatikisht. Dakord. Unë jam në përpjekje që ta riformoj dhe rirregulloj Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe ta përgatis për Ligjin e ri të shërbyesve civilë dhe të mos trashëgoј të njëjtën si të them grupizim të punëtorëve, kryesisht në staf teknik, por ta riorientoј Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në një strukturë që i përgjigjet sfidave dhe kërkesave të kohës.

Kosova tani është anëtarësuar në shumë institucione ndërkombëtare dhe në vend që t'i kem unë 15 shoferë atje, më duhen 15 ekspertë dhe nuk më duhen shoferë të cilët i vozisin drejtorët deri në Lipjan për shembull. Pra, qëllimi im është ta orientoј Ministrinë në ekspertë dhe jo në numër të stërmadhuar të punëtorëve nëpër sektorë të cilët tanimë nuk do të duheј të ishin aty, por do t'i bëј të gjitha konform ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Në mungesë të bazës ligjore dhe sanksioneve, kompanitë e sigurimeve kanë dëshmuar se nuk e bëjnë kompensimin e dëmit. Madje edhe me aktgjykimin e formës së prerë nga gjykata, qytetarët po kanë probleme t'i realizojnë të drejtat e tyre. Një mundësi e mirë e cila do të rriste sigurinë e realizimit të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, është miratimi i Ligjit për sigurimet. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe faktin se i njëjti është në strategjinë legjislative për këtë vit, për

ministrin e Ekonomisë dhe Financave, bëj këtë pyetje: Në cilën fazë të përgatitjes është ligji i përmendur?

KRYETARI: Ministër.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja deputete Dauti,

Në Strategjinë legjislative të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2010, bëjnë pjesë edhe Ligji për sigurimet dhe Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta. Me kënaqësi mund t'ju informoj se Projektligji për sigurimet sipas strategjisë legjislative është paraparë të dorëzohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës, më 30 korrik, besoj që do ta aprovojmë më herët se sa nga koha kur kemi planifikuar në planin origjinal. Projektligji është në proces të hartimit nga ekspertë të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, Bankës Botërore dhe Bankës Qendrore të Kosovës, do t'ju ftoja personalisht juve duke pasur parasysh ekspertizën tuaj që të na bashkëngjiteni në parapërgatitjen përfundimtare të tij. Po ashtu Projektligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia ndaj palëve të treta sipas strategjisë legjislative të vitit 2010, është paraparë që të dorëzohet më 30 nëntor, ne besojmë që edhe këtë ligj do ta dorëzojmë këtu në Parlament para afatit, diku në shtator edhe për këtë do t'ju ftoja që së bashku të punojmë dhe kështu përmbushim një vakum nëse mund të them legjislativ dhe një obligim tonin ndaj këtyre përgjegjësive tepër të rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe shtetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë?

NERXHIVANE DAUTI: Pyetje shtesë nuk kam, por e falënderoj ministrin dhe ministrinë përkatëse për punën e bërë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, ju keni dëmtuar demokracinë sot duke zbatuar nenin 47 në mënyrë parciale. Është dashur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës sipas rregullave në fuqi të flasë e treta. Mos harroni, opozita është pjesa vitale e demokracisë.

Pyetja ime për kryeministrin është: Zoti kryeministër, po bëhen gati 2 vjet e gjysmë nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe Qeveria nuk po arrin ta kontrollojë kufirin në veri. Më shumë po sodit prej së largu se çka po ndodhë, se sa që është aktore. Kjo po shkakton që në Kosovë të hyjnë në mënyrë të pakontrolluar njerëz dhe mallra, me një fjalë Qeveria nuk e di se kush hyn dhe del nga shteti dhe çfarë mallrash hynë dhe dalin nga shteti. Pyetja ime: Pse nuk është angazhuar Qeveria të vë nën kontroll të plotë kufirin në veri dhe si do të veprojë më tej? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar, faleminderit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuara deputete Sylja,

Që nga viti 1999, por sidomos nga shpallja e pavarësisë së Kosovës edhe në veriun e Mitrovicës ka pasur angazhime të pakursyera që të kthehet ligjshmëria, që të ndalet kontrabanda, korrupsioni, që të defunksionalizohen strukturat paralele, ato ekstremiste, por edhe radikale. Qasja e Qeverisë së

Republikës së Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare ka qenë, është dhe mbetet vendosja e plotë e ligjshmërisë në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, përmes zbatimit të plotë të dispozitave të presidentit Ahtisari dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ne u kemi dhënë mbështetje të plotë gjithë angazhimeve të cilat i ka bërë Policia e Kosovës, EULEX-i, KFOR-i, që të ndërmarrin masa urgjente për të ndaluar apo tejkaluar këtë gjendje jo të dëshirueshme në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Por e theksoj se Qeveria që e udhëheq unë, është Qeveria e parë që ka filluar të investojë në këtë pjesë të Republikës së Kosovës, dhe ka një angazhim konkret dhe strategjik, qoftë për vënien e ligjshmërisë, qoftë për formimin e komunës së re, gjithashtu edhe për mundësinë e organizimit të zgjedhjeve të lira dhe zgjedhjen e liderëve të rinj legjitim edhe në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, por edhe angazhimet tona socio-ekonomike.

E gjithë kjo është e hartuar edhe në strategjinë gjithëpërfshirëse për veriun, pra që inkorporon masa demokratike dhe ligjore për vendosjen e rendit dhe të ligjit.

Qeveria dhe unë do të vazhdojmë të kemi konsulta të ngushta me komunitetin ndërkombëtar, qoftë me EULEX-in, ICO-n, KFOR-in dhe gjithë mekanizmat tjerë mbështetës. Dhe dua të theksoj se pas suksesit të jashtëzakonshëm që kishim të dielën e kaluar në organizimin e zgjedhjeve të lira në Partesh, është hapur edhe mundësia tjetër që të lëvizim në këtë drejtim.

Por i nderuari, zoti kryetar, pasi që u diskutuan edhe më herët pak do t'i shtoja disa angazhime shtesë të cilat i ka pasur Qeveria e Republikës së Kosovës edhe në këtë drejtim, por që dëgjuam këtu edhe me herët në formë të pyetjeve.

Dëshiroj të theksoj se Republika e Kosovës është në një proces shumë të mbarë për dialogun për liberalizimin e vizave para përmbylljes së verës dhe kjo gjë na është konfirmuar edhe në takim me komisionarin për Zgjerim Evropian zotin Fule. Gjithashtu, edhe hapjen e perspektivës për marrëdhënie tregtare me Bashkimin Evropian dhe procesin e asocim- stabilizimit. Ndërsa e theksoj këtu pasi që po hapet si diskutim edhe opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare për statusin e Kosovës, ne po e përmbylлим definitivisht procesin e pavarësisë së mbikëqyrur për Kosovën dhe po hapim një kapitull të ri, atë të integritetit në NATO dhe në Bashkim Evropian. Dhe opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare për statusin e Kosovës do të shënojë një fillim të ri, një etapë të re, konsolidimin e shtetit tonë, por edhe hapin e perspektivës së sigurt integruese evrop – atalnike dhe perspektivën edhe më të mirë për zhvillimin ekonomikë e në të njëjtën kohë edhe procesin për integritet në NATO, në partneritetin për paqe, por edhe plane tjera vepruese.

Pajtohem plotësisht me deputetin Rexhepi, dhe jemi të gatshëm kurdoherë si Qeveri që të hapet debat, qoftë për ndërtimin e autostradës, për investime që po ndodhin, për drejtimin, por pajtohem gjithashtu të gjithë, ju lutem, ju lutem,

(Reagim nga salla)

Por pajtohem të gjithë që autostrada duhet të vazhdojë së ndërtuari, këto ditë po fillon me kapacitet të plotë puna kështu që veç për hair na qoftë të gjithëve. Ndërsa dëshiroj përsëri të theksoj se ndihem tepër i përgjegjshëm në angazhimet që kemi pasur, në suksesin e jashtëzakonshëm të koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës për procesin shumë transparent dhe përsëritur nga gjithë bota demokratike. Ne do të punojmë me standarde perëndimore dhe jo me mentalitete të së kaluarës. Në anën tjetër, gjithashtu plotësisht jam i gatshëm, por edhe e kam obligim kushtetuese pasi që në Qeveri veç ka kaluar vendimi për privatizimin e PTK-së, kjo çështje do të vijë për diskutim këtu në Kuvend

dhe natyrisht se kam besim të plotë se do të kemi një mbështetje unike tuajën për hapat tonë të mëtutjeshëm që të vazhdojmë me proceset tona angazhuese.

Gjithashtu edhe për procesin e ndërtimit të termocentralit Kosova e Re. Ju falënderoj për mbështetjen që keni dhënë dhe do të vazhdohet me procese të cilat i kemi diskutuar bashkërisht dhe do të vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Dëshiroj të theksoj gjithashtu se të gjitha këto angazhime janë në drejtim të forcimit të sektorit privat dhe ndikimit që ka qenë i mëhershmi i Qeverisë në ndërmarrjet publike, për të larguar pra ndikimin e Qeverisë nga udhëheqja e ndërmarrjeve publike.

Por, gjithashtu dua të potencoj edhe sa i përket opinioneve që janë prezantuar edhe angazhimeve për relacionin e ri me Serbinë. Ne do të ndërtojmë raporte të fqinjësisë së mirë me të gjitha vendet e rajonit dhe secili vend e ka edhe specifikën e vet të bashkëpunimit, por në asnjë rrethanë statusi politik i Kosovës, pra Kosova shtet i pavarur dhe sovran, nuk është i kontestuar nga askush nga ata që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe nuk do të ketë rikthim prapa, por vetëm ecje përpara dhe njohje të reja. Integriteti territorial i Republikës së Kosovës është dhe do të mbetet i njohur dhe i pranuar ndërkombëtarisht dhe i paprekshëm. Gjendja në veri është e papranueshme dhe po punojmë për të ndryshuar, ndërsa unë përsëri për ata që nuk e kanë dëgjuar mirë, do të rilexoj formulim tim të qartë edhe për veriun e Mitrovicës. Pra, do të gjejmë forma të reja të bashkëpunimit që njohin natyrën e veçantë të këtyre angazhimeve duke ruajtur tërësinë e plotë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet tona, pra tërësinë e plotë territoriale të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë? E ke fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Kryeministër, duke mos dhënë përgjigje të saktë..., po t'i numëroj rezultatet e angazhimit të Qeverisë.

Një, derisa për zgjedhjet e Serbisë në Kosovë erdhi Koshtunica me njerëz të armatosur dhe Nikoliqi duke bërë fushatë për ndarjen e Kosovës, mallrat, sidomos nafta po kontrabandohet dhe po rrënon ekonominë e vendit. Dje erdhi edhe ashtuquajtura Garda e Car Lazarit, duke thyer kufirin, a po ndodh kjo për shkak të paaftësisë së Qeverisë të vë kontroll në kufij apo është pjesë e ndonjë marrëveshje të fshehtë? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, a e do fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë e kuptoj energjinë tuaj, deputete Sylja, për angazhime edhe më konkrete dhe kjo energji është mjaftë inkurajuese, por në të njëjtën kohë po dalloni në qëndrime prej lidershit të partisë suaj, sepse shumë angazhime i kanë përshëndetur ata në konferencat për shtyp. Të lutem, të lutem, ndërsa unë ju kisha ftuar që t'i përshëndetni të gjitha ata hapa konkret, të mirë, që janë bërë edhe në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, ndërsa të gjitha vendimet, puna ka qenë është dhe do të mbetet transparente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Adem Hajdaraj, pyetje për kryeministrin apo ministrin Enver Hoxhaj. Deputet e ke fjalën.

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit!

Zoti kryetar,

Unë ka kohë që e bëj këtë pyetje, por më vjen mirë që janë të dy këtu sot. Po e lexoj pyetjen. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Ministrisë së Arsimit, në vitin 2009 ka nxjerr

rekomandimin për shtyrjen e moshës së pensionimit të profesorëve universitarë. Kjo është mirëpritur nga Universiteti i Prishtinës, i cili, në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme kadrovike, ka siguruar vazhdimin e punës së mësimdhënësve të shquar edhe pas arritjes së moshës së pensionimit. Por, përkundër këtij vendimi të Qeverisë dhe premtimit të vazhdueshëm, ky vendim nuk po zbatohet, vendim edhe qëndrimi i mëparshëm, e kam këtu edhe qëndrimin, për aq më tepër kur më parë i është ndalur paga kësaj kategorie të mësimdhënësve, profesorëve ordinarë dhe inordinarë edhe përkundër kërkesës së Rektoratit të Universitetit të Prishtinës për vazhdimin e pagës së tyre edhe pas moshës së pensionimit. Ata këtë vit akademik po thuaj se e kanë përfunduar.

I nderuar kryeministër dhe ministër Hoxhaj,

Kuvendi i Kosovës, para pak ditësh e ka miratuar Ligjin për nëpunësit civilë, me të cilin profesorët universitarë largohen nga skema e shërbyesve civilë dhe kategorizohen në nëpunësit të veçantë shtetëror e shkencor. Miratimi i këtij ligji edhe përfundimisht ka krijuar bazën ligjore për shtyrjen e pensionimit të profesorëve universitarë dhe rregullimin e kësaj çështjeje me akte ligjore. Pikërisht për këtë unë shtroj edhe pyetjen parlamentare.

Zoti kryeministër, zoti ministër,

A mund të na informoni se kur do të hyjë në fuqi vendimi, respektivisht qëndrimi i Qeverisë për shtyrje të pensionimit të profesorëve të lartcekur dhe çfarë masash jeni duke ndërmarrë për ...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar, kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Shumë i respektuar deputet Hajdari, i nderuar profesor,

Më lejoni që ta precizoj në formën se si e patët edhe ju në fillim në pyetjen dhe në qëndrimin tuaj në komentin tuaj. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka nxjerr një vendim, por ka rekomanduar ose ka nxjerrë një qëndrim që profesorëve të Universitetit të Prishtinës sipas nevojave të Universitetit të Prishtinës t'ju shtyhet moshja e pensionimit. Situata aktuale është që Ligji i vjetër për arsimin e lartë e rregullon këtë çështje ku statutit të Universitetit të Prishtinës i jep kompetenca të plota që të vendosë për një çështje të tillë. Dhe unë kam dëshirë t'ju lexoj nenin 191, në pikën 2 ku thuhet që: "Procedurat dhe kushtet për revokimin e titujve, suspendimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe pensionimi i stafit, përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga Këshilli drejtues, pasi të jenë të konsultuar me Senatin e Universitetit të Prishtinës. Ky paragraf flet për atë që është e drejtë autonome e Universitetit të Prishtinës që të vendosë për atë se kur duhet të pensionohen profesorët në Universitetin e Prishtinës dhe nuk është punë e Qeverisë, meqë Universiteti i Prishtinës është korporatë apo ndërmarrje publike.

Situata aktuale është kjo, ka shumë punëtorë të cilët Universiteti i Prishtinës i ka angazhuar me kontratë mbi vepër, mirëpo ligjërisht nuk ka mund t'ua

shtyjë kohën e pensionimit, meqë me statut është rregulluar në këtë formë dhe me ligjin në fuqi dhe ka shumë të tjerë të cilët, mjerisht nuk e kanë pasur këtë mundësi që të integrohen edhe më tutje në procesin mësimor. Mendoj që i takon vetë Universitetit të vendosë se për cilat programe do të duhej të angazhojë profesorë dhe për të cilat jo.

Një situatë e qartë do të jetë për javët dhe muajt në vijim. Ne do ta sjellin ligjin e ri për arsimin e lartë në Kuvendin e Kosovës, ju deputetë të nderuar do ta miratoni këtë ligj. Në përputhje me ligjin e ri do të sillet edhe statuti i ri i Universitetit të Prishtinës dhe nëse ju vendosni që koha e pensionimit të profesorëve në Universitetin e Prishtinës duhet të jetë në moshën 70- vjeçare, ky vendim mandej duhet të respektohet brendapërbrenda vetë Universitetit të Prishtinës...

KRYETARI: Mirë, vazhdoja regjia për një minutë.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Prej anës tonë, si qeveri, është po thuaj se e pamundur që të vendosim për punëtorët e Universitetit të Prishtinës, që nuk janë të punësuar të Qeverisë, por të cilët janë të punësuar të Universitetit të Prishtinës si ndërmarrje autonome e pavarur publike, për të cilën ata duhet të vendosin. Ftesa ime është që iniciativën që ju e keni pasur profesorë që unë e kam sjell në mbledhje të Qeverisë në formën e qëndrimit edhe të shumë profesorëve të Universitetit të Prishtinës, kjo iniciativë të rregullohet me atë kur të vijë ligji i ri në Kuvend të Kosovës dhe kur të vijë statuti i ri që duhet të dalë nga Ligji i ri për arsimin e lartë dhe njëherë e përgjithmonë realisht të vendoset një standard. Përvojat në Evropë janë të llojllojshme. Ka në Evropë vende të cilat i pensionojnë me 63 vite, ka vende të cilat i pensionojnë me 70 vite, po ka vende në të cilat ka edhe kategori të profesorëve emeritus, të cilët deri në momentin sa janë në jetë, kanë kapacitet intelektual të japin kontributin....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë, apo je i sqaruar?

KRYETARI: Pyetje shtesë. Fjala për deputetin Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës, unë desha vetëm të theksoj edhe njëherë, në pyetjen se a janë krijuar kushtet me rastin e miratimit të Ligjit për shërbyesit civilë, meqë nuk janë përfshirë profesorët, që me një akt, domethënë, me një udhëzim administrativ të rregullohet kjo çështje derisa të miratohet ligji, dhe e kam këtu edhe vendimin e Qeverisë, në të vërtetë qëndrimin, Qeveria e Kosovës merr vendim që mosha e pensionimit mandator të profesorëve ordinarë dhe jo ordinarë dhe të asociuar të Universitetit të Prishtinës të shtyhet nga mosha 65, sa është tani, në moshën 70. I rekomandohet Grupit punues që ta rregullojë këtë, kryetari i Qeverisë së Kosovës, domethënë kryeministri Hashim Thaçi e nënshkruan dhe e kam pasur në dorë edhe një udhëzim administrativ, ku shkruan...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet, po ti e di që qëndrimi nuk e ndryshon Ligjin. Nëse ke përgjigje, ministër!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Profesor i nderuar, edhe pas nxjerrjes së Ligjit të ri për shërbyesit civilë, unë mendoj që për punëtorët e Universitetit të Prishtinës është një dallim skajshmërisht i madh pozitiv për pozitën e tyre. Meqë nuk janë shërbyes civilë, por janë shërbim profesional i Republikës së Kosovës dhe të punësuar në Universitetin e Prishtinës, është e pamundur për shkak se Statuti i Universitetit të Prishtinës, që është miratuar në Kuvendin e Kosovës, ky Kuvend e ka miratuar Statutin e Universitetit të Prishtinës, e përcakton shumë qartë që Këshilli Drejtues, në konsultim me Senatin merr vendim për kohën e pensionimit të profesorëve të Universitetit të Prishtinës. Përderisa është e definuar në këtë formë me Statutin aktual të Universitetit të Prishtinës dhe me Ligjin aktual për arsimin e lartë, ne si Qeveri nuk mund të marrim vendim mbi një dokument, i cili është nxjerrë

nga vetë Kuvendi i Kosovës, ndërsa jam shumë i sigurt që nuk kemi marrë vendim, por ka qenë qëndrim, qëndrim dhe ka dallim në mes qëndrimeve.

Unë nuk mund t'ju premtoj se kjo çështje mund të zgjidhet brenda dy-tri ditësh, mirëpo një gjë ju premtoj që, nëse deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të interesuar, ku ka shumë profesorë të Universitetit të Prishtinës dhe ne si qeveri jemi shumë pozitiv në këtë hap, kur të vjen Ligji i ri për arsimin e lartë në Kuvendin e Kosovës, kur Universiteti i Prishtinës e sjell Statutin e ri, vendosni ju për kohën në të cilën do të duhej të ndodhë pensionimi i vetë profesorëve të Universitetit të Prishtinës.

KRYETARI: Mendoj që deputeti është i qartë tash. Vazhdojmë. Deputeti Ismail Kurteshi, pyetje për ministrin Sadri Ferati.

ISMAIL KURTESHI: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Përshëndetje për Kabinetin qeveritar, për deputetët!
I nderuar zoti ministër,

Ju dhe Ministria që ju e drejtoni, decentralizimin dhe formimin e komunave të reja me shumicë serbe e keni arsyetuar me integrimin e komunitetit serb dhe njohjen e institucioneve të Kosovës nga këto komuna. Komuna e Artanës ka hyrë në zgjedhjet lokale të 30 majit 2010, të organizuara nga Serbia, përkundër faktit që në këtë komunë zgjedhjet janë mbajtur edhe në nëntor të vitit të kaluar dhe me atë rast janë zgjedhur edhe organet komunale dhe kryetari i komunës.

Zoti ministër, a do të thotë kjo se serbët nuk janë të interesuar të integrohen dhe kështu po dështon i ashtuquajtur i proces i decentralizimit, që në të vërtetë është ndarje në baza etnike dhe, pyetja tjetër është: pse në komunat e reja: Graçanicë, Kllokot, Ranilluk dhe në komunën e Shtërpçës nuk janë vendosur ende simbolet e Republikës së Kosovës, përkundër faktit se në këto komuna, do të thotë, janë institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e organizuara në Kosovë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
I nderuar deputet Kurteshi,

Vërtet procesi i decentralizimit nuk ka pasur nevojë shumë të arsyetohet ngase për rëndësinë dhe vlerën e tij është ditur që më herët, që me futjen e tij në Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës. Ka qenë në mandatin tim të Grupit ndërmnisht, por edhe të gjithë faktorëve që e kanë ndihmuar këtë proces, që ne ta bëjmë të mundshëm që ai të implementohet me qëllim që qytetarëve t'ju ofrohen sa më afër shërbimet, të ndërtojmë institucione të fuqishme që do të mundësojnë shërbime të mira për qytetarët dhe që do të ndikojnë në zhvillimin e jetës, pra, nëpër komunat e tyre.

Njëkohësisht, ka qenë ambicie dhe motiv shumë i mirë që nëpërmes ndërtimit të këtyre institucioneve, futjes së gjithë qytetarëve në proces, marrjes së këtyre kompetencave, menaxhimit të këtyre kompetencave do të jetë e mundshme që të fitohet kualiteti i jetës dhe secili qytetar i Kosovës ta ndiej barazinë qytetare që ju garanton Kushtetuta, ligjet dhe ta ndiejnë mundësinë që ata të menaxhojnë me ato të drejta në nivelin lokal, të cilat të drejta vërtet janë të fuqishme dhe ligjet e Republikës së Kosovës mundësojnë një autonomi të fuqishme në atë drejtim. Aty ku ne kemi pasur qasje, institucionet e Republikës së Kosovës, partnerët ndërkombëtarë dhe të gjithë të tjerët, kualiteti dhe progresi është evident.

Një prej atyre janë edhe komunat që ju i përmendët tash, pra edhe Artana, ku kanë mbajtur zgjedhje, është instaluar kryetari, është instaluar Asambleja komunale, është kompletuar administrata dhe gjithkund është respektuar Ligji për vetëqeverisjen lokale, Ligji i Republikës së Kosovës, ku e kemi kryetarin dhe nënkryetarin nga komuniteti jo shumicë, kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, kemi të punësuar në administratë, domethënë shumë etnike dhe numri i qytetarëve të cilët ofrohen me komunën, marrin shërbime, çdo ditë është edhe më i madh dhe procesi i decentralizimit në përgjithësi, po edhe integrimi i të gjithë qytetarëve, duke përfshirë edhe ata të komunitetit serb, është një proces dhe ne jemi të kënaqur me progresin momental, por ne do të vazhdojmë t'i inkurajojmë dhe t'i mbështesim komunat tona që tani ata, në cilësinë e liderëve lokalë, së bashku me të gjitha strukturat ta vazhdojnë këtë proces të kualitetit të jetës, shërbimet më të mira dhe integrimin e të gjithë qytetarëve në institucionet e Republikës së Kosovës.

Edhe unë pajtohem me ty se sikur të kishte dështuar decentralizimi, vërtet do të kishte mundur të thellohet kjo ndarje etnike. Për fat të mirë, institucionet e Republikës së Kosovës, partnerët, e gjithë Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi po krijojnë parakushte që kjo të mos ndodhë, pra që kudo qytetarët e Republikës të Kosovës të ndihen se janë të barabartë, kanë mundësi të barabarta, se mund të jetojnë në një bashkëjetesë, në një fqinjësi të mirë dhe të ndërtojnë një perspektivë të përbashkët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdo, veç përgatitu për tre minuta. Shkurt, vazhdo një minutë!

SADRI FERATI.....pra, në pyetjen e dytë, se ishin dy pyetje, në pyetjen e dytë, në Shtërpçë ekziston mbishkrimi dhe emblema, ashtu siç parashikohet me ligj, ndërsa në komunat e reja: Graçanicë, Klllokot dhe Ranilluk, tani ka qenë procedura e miratimit të simboleve, të cilat pas miratimit në asamblatë komunale, bëhet vlerësimi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe pastaj ato rikthehen në të gjitha procedurat tjera. Jemi në vlerësim e sipër. Graçanicës i është kthyer përgjigja që duhet ta rishikojë këtë vendim, ndërsa po shpresoj se me Klllokotin dhe me Rranillukun gjithçka do të shkoj mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tjera herë, ju lutem, ju i dini rregullat, lexojeni Rregulloren e Punës dhe e shihni sa zgjatë pyetja dhe sa zgjatë përgjigja. Pyetjet edhe përgjigjet do të jenë mbi bazën e Rregullores të Punës së Kuvendit. Kërkoj ta keni këtë parasysh se tjera herë nuk ia zgjasë fjalën askujt.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Zoti ministër, nga prona e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, që para luftës kishte 43 hektarë e 082 ari, tash kanë mbetur rreth 37 hektarë e 14 ari, me fjalë tjera kanë humbur edhe 6 hektarë, që sipas disa parallogarite kapin vlerën nga 20 milionë euro. Sa për hir të argumenteve, thuhet se në vitin 2004, QKU kishte 39 hektarë e 76 ari, që domethënë se janë tjetërsuar nga viti 2004 deri sot 2 hektarë e 62 ari, që vlejnë rreth 9 milionë euro.

Pyetja është kjo, zotëri ministër, ku mbeti prona e QKUK-së, kush e tjetërsoi apo e shpronësoi dhe sa nga ata që tjetërsuan pronën publike, sa janë persona publikë dhe udhëheqës të institucioneve të rëndësishme të Kosovës? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Ju faleminderit, zoti Tali!

Dikush na ka hyrë në megjë, por nuk është avulluar, natyrisht, ajo tokë. Edhe unë i kam ato të dhëna, të cilat ju i thoni, domethënë nuk ka këtu, nuk kontestohet ajo se në vitin '58, kanë qenë 43 hektarë e 82 ari, në vitin 1980, 43 hektarë e 82 ari, dhe pastaj del një ndryshim që ka dalë sipas listës poseduese të vitit 2004, nga Departamenti i Kadastrit të komunës së Prishtinës, që Qendra e Klinikës Spitalore tani, Qendra Klinike Spitalore, jo Spitali i Përgjithshëm i '58-shit, ka 42 hektarë, 7 ari, 29 metra katror. Pastaj, në fund vjen kopja e planit të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit të vitit 2008, që thuhet se tash i paskemi 38 hektarë, 41 ari dhe 41^{m2}.

Po ashtu, ju me të drejtë e shtroni pyetjen se këtu ka disa ndryshime sepse, sipas kopjes të planit tash të fundit, jepet se nuk është kjo një copë, por paska disa parcela me destinime të ndryshme dhe janë të përmbledhura, të gjitha këto bëjnë tash total 40 hektarë, 7 ari e 68^{m2}.

Për të mos ju lodhur as juve, as kolegët, konkludimi është i thjeshtë. Këtu nuk ka qartësi rreth këtij territori. Natyrisht, janë marrë disa veprime rreth sqarimit të kësaj. Nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës është kërkuar nga Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës që të verifikohet saktësia, nën një, e sipërfaqes të tokës urbane sot, domethënë aktualisht edhe në bazë të dokumentacionit në dispozicion të definohen shfrytëzuesit e ligjshëm të kësaj toke.

Unë e marrë atë zotim edhe njëherë se shfrytëzuesit e paligjshëm të kësaj toke do të eliminohen, si të them, me të gjitha mjetet ligjore. Nuk po ndiej një nevojë të madhe tash, si të them, të jap deklarata të zjarrta, por ju siguroj se është, do me thënë, në proces të sqarimit. Nuk e di sa ditë do të zgjatë kjo përgjigje dhe ne do t'i rrimë gati kësaj dhe do të jemi në dispozicionin tuaj, rreth territorit, domethënë, dhe rreth, të themi, uzurpatorëve, se unë po shoh, është një aludim se janë uzurpuar ato. Uzurpatorët do të eliminohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

DRITON TALI: Zoti ministër, drejtori i QKUK-së tha se emrat janë atje, i keni në QKUK dhe se është në gjendje që t'i publikojë emrat. Edhe një herë po e përsërisë pyetjen dhe mua më interesojnë personat publikë të cilët e kanë uzurpuar. Tash veç, po them, koalicioni qeveritar i keni përmirësuar marrëdhëniet, që nuk di diçka, mund ta pyesësh edhe zotin Ahmet Shala, goxha do sende i di, ai ka qenë në AKM. Por, mund t'i pyesësh edhe kolegët në partinë tënde, se Prishtinën e ka udhëhequr LDK-ja pas luftës, kështu që ata emra janë të njerëzve fizikë, të njerëzve që ekzistojnë. Siç thatë, nuk është avulluar ajo tokë dhe pres nga ju që emrat e uzurpuesve, të shpronësuesve t'i publikoni, edhe të atyre që brenda QKUK-së, pra, i kanë disa restorante, e kanë uzurpuar oborrin e QKUK-së. Ju faleminderit!

KRYETARI: A ishte pyetje shtesë a çka ishte kjo, nuk po e di? Urdhëro! Ministër, a ke përgjigje, koment. Urdhëro, e ke fjalën!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Zoti Tali, unë të vetmen gjë që mund t'ju siguroj, uzurpuesit, nëse konstatohen, nëse emërohen, nëse identifikohen këta uzurpues, por pa paragjykime, e kjo nuk është puna ime, nuk dua ta luaj këtu prokurorin, domethënë nuk ka nevojë kurrfarë që të mbërthehemi dhe t'i paragjykojmë gjërat këtu në këtë vend. Në atë moment kur ato, për shembull, janë në dispozicionin tim, informatën që e marr, unë ju siguroj se do të informoheni ju dhe varg të gjitha institucionet.

Nuk e di, me muaj, me tahmin, duke marrë parasysh se na të gjithë mzi po presim edhe 10 ditë për të shkuar nëpër pushime, nëpër dete dhe nja 2 muaj i kemi shumë, por unë në shtator do të jem në gjendje gjatë muajit shtator, ma merr mendja. Edhe tjetra, ju lutem, nuk është kjo çështje partiake,

nuk e konsideroj kështu, domethënë, ishte aludimi aty se këta njerëz atje... Ai që zihet në flagrancë, ju lutem, le të përballet me gjyqësinë....

(Driton Tali, ndërhyrje nga salla)

...Nuk di unë a kanë vjedhur, hajnat do t'i ndjekim të gjithë së bashku. Ju faleminderit!

KRYETARI: Jo. Jo, nuk merret tash, jemi në pyetje-përgjigje, ju lutem! Nuk jemi në debat këtu. Edhe mënyra qysh po komunikohet, vërtet është jashtë çdo norme. Nuk kemi nevojë për sqarim, jemi në pyetje dhe përgjigje parlamentare, nuk jemi në debat. Ju lutem!

Deputeti Ismail Kurteshi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

ISMAIL KURTESHI: I nderuar zoti kryetar,

Zotërinj ministra,

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër, njëra ndër arsyt e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ka qenë edhe është rritja e prodhimtarisë në nivel të vendit dhe krijimi i fondeve për investime të reja që do ta rrisnin prodhimtarinë dhe punësimin. Sa jeni ju i kënaqur me rritjen e prodhimtarisë dhe të punësimit në nivel të vendit dhe cilat janë rritjet konkrete në lëmin e prodhimtarisë dhe të punësimit dhe cilat janë investimet konkrete nga Fondi i Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti deputet,

Të faleminderit, më së pari, konsideroj për një çështje të cilën mbase do të duhej një sqarim shumë më i gjerë, por do të përpiqem brenda 3 minutave, sa më lejon Rregullorja, të jap ca informacione të cilat unë, si ministër për Ekonomi dhe Financa do të duhet t'i sqaroja, mbase, edhe pse për të gjitha pyetjet do t'ju lusja, sa i përket kësaj çështjeje t'i drejtoheni Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që është institucion që i përgjigjet Kuvendit.

Megjithatë, në efektet e procesit të privatizimit ka shumë debate, varësisht nga cilat shkolla të mendimit, cilat qasje, në cilat rrethana zhvillohet ai proces, cilët janë objektivat e tij dhe në rrethana çfarë është bërë në Kosovë, pra, duke pasur parasysh specifikat ligjore, politike, trashëgimisë së strukturës ekonomike, konsideroj që, megjithatë, duke pasur parasysh të gjitha këto, janë arritur rezultate të konsiderueshme, jo të shkëlqyeshme, jo të kënaqshme, çfarë do të donim të gjithë ne t'i shihnim, por në rrethanat, po e përsëris, janë arritur rezultate të shkëlqyeshme, të kënaqshme, më falni, prej të cilave defekti i vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik është mos mundësia e përdorimit të Fondit të Privatizimit për zhvillim ekonomik të vendit, që ka status të qartë politik, që ka sovranitet të plotë mbi resurset e veta, asetet e veta, është instrument për alokimin e atyre mjeteve për zhvillim ekonomik. Andaj, duke i pasur ato rrethana, kjo fatkeqësisht në Kosovë nuk ka mund të ndodhë. Tash pas pavarësisë, besoj se po përpiqemi t'i gjejmë format më të përsheptuara që ato fonde të jenë në të mirë të zhvillimit ekonomik.

Pa marrë parasysh të kësaj, dy janë elemente të cilat ne si ekspertë, si shoqëri, kushdo që të jetë, i ka në duart e veta për t'i matur efektet e një procesi dhe efekti është: zhvillimi ekonomik, rritja e eksporteve, rritja e prodhimit vendor apo rritja e punësimit. Dihet që privatizimi, të paktën në shtetet e tranzicionit, nuk krijon rritje të punësimit nominal, por ndikon në rritjen e punësimit të qëndrueshëm dhe konsideroj që në shumicën e rasteve është arritur ky.

Në aspektin e instrumenteve matëse, unë mund t'ju jap disa shifra të cilat mund të justifikojnë këtë që po e them unë. Në vitin 2000 ose 2003, eksporti ka qenë rreth 4 milionë. Në vitin 2005 ka qenë rreth 15 ose 30 milionë dhe tani i kam shifrat e sakta: në vitin 2006, - 110 milionë; më 2007 - 154 milionë; më 2008 – 196 milionë; më 2009 - 165 milionë. Nëse këto janë shifra të cilat e kanë dhjetëfishuar eksportin e Kosovës nga vendi, unë jam shumë i sigurt që një pjesë e tyre është meritë e disa sukseseve në proces të privatizimit dhe ato disa nga kolegët e mi nga AKP-ja m'i kanë sjellë disa raste, storie të suksesshme, të cilat besoj që kanë ndikua në ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Unë edhe një herë po ju lus deputetët dhe ministrat ta respektojnë kohën, siç është e paraparë në Rregullore. Nëse ministrat nuk mund të përgjigjen për 3 minuta, mos të përgjigjen hiq!

Deputet, e ke fjalën për pyetjen shtesë.

ISMAIL KURTESHI: Zoti ministër,
Ju a e konsideroni privatizimin si sukses apo si dështim? Nëse është sukses, numëroni disa nga sukseset, ju lutem. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Në rrethanat politike dhe juridike në të cilat është zhvilluar procesi i privatizimit në Kosovë, e konsideroj të suksesshëm, pa marrë parasysh të metat e veta që i ka për shkak specifikave që i përmenda. Suksese të cilat mund, do t'i numëroja dhe të cilat i kam të shkruara dhe do t'i jap këtu, për shkak të kohës, mund të jenë: eksporti i rritur në Kosovës; punësimi i qëndrueshëm; hapja e perspektivës së menaxhmentit modern dhe hapja e mundësisë së zhvillimit ekonomik në Kosovë. Do të duhej të zhvillohej një debat i tërë, mbase jashtë parlamentar, edhe pse jo në parlament këtu sa i përket këtij procesi, por për hak të kohës unë do t'i jap këtu nja 10-15 raste, storie të suksesshme, të cilat besoj që kanë ndikuar edhe në rritjen e GJDP-së në Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

Pyetja ime sigurisht që po bashkëngjitet edhe mund të ngjallë asocime me pyetjet e deputetit Tali, po i bëjmë ndonjëherë edhe bashkë dhe pyetja ka të bëjë me ministrin e Ministrisë për Shëndetësi së Republikës së Kosovës, Bujar Bukoshi, që ka iniciuar procedurën e shkarkimit të drejtorit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, zotin Ali Sadrija.

Drejtori ekzekutiv, në mënyrë shumë transparente pat bërë publike shumë afera korruptive që përcjellin punën e QKUK-së, si dhe pat bërë publike aferën e shpronësimit apo dhënien në shfrytëzim ndërmarrjeve private në mënyrë të paligjshme dhe paushall të tokave publike, që për dekada me radhë kanë qenë në shfrytëzim të QKUK-së. Pyetja ime është orientuar: cilat janë arsyet e vërteta që ju keni iniciuar shkarkimin e drejtorit ekzekutiv, sepse argument është se drejtori ekzekutiv pat bërë publike disa prej aferave brenda, kurse një porosi për ish kryetarin e Prishtinës, Ismet Beqiri, kam se nuk është mirë për t'u kruar aty ku të kruhet, sepse unë e kam parë me sytë e mi dhe ju e dini të gjithë....

KRYETARIT: E ke keqpërdor mikrofonin!

NAIM RRUSTEMI: ...jo, edhe ai ka folur.

KRYTARI: Jo, pyetjen e ke për këtë.

NAIM RRUSTEMI: Për kë, për Bujar Bukoshin, a?

KRYETARI: Atij nuk i është dhënë mikrofon, ai ka folur pa mikrofon, ti e ke mikrofonin hapur vetëm për të bërë pyetje.

NAIM RRUSTEMI: Po e kam mikrofonin dhe po flas. Veç nuk është mirë, ju lutem, nuk je baba i Kuvendit këtu për të dhënë gjithaq shpjegime për secilin çka flet. Unë i kam dy minuta, flas atë çka dua edhe çka e them, në kuadër të pyetjes është.

KRYETARI: Regjia ia mbyll, ia ndal fjalën dhe nuk ka përgjigje në këtë pyetje!

(Reagime nga salla)

Regjia, i fton deputetët në sallë.

Me gjithë respektin, kryetar, ne nuk jemi në rend dite për këtë çështje. Këto janë pyetje parlamentare dhe përgjigje parlamentare. Nuk ka debat. A e kuptoni këtë që nuk është debat. Po, ju lutem, kjo nuk është pyetje që të përmendet emri e të flasësh tash. Bëni debat, kërkon debat, flisni çka të doni. Po ju lus, s'ka mirëkuptim. Rendi i ditës është: Pyetje e përgjigje. Jo unë po kërkoj prej jush që ta respektoni Rregulloren e Punës.

(Reagime nga salla)

Nuk ka fjalë. U krye puna. Edhe pika e rendit të ditës u krye. Edhe po ju them, atëherë që keqpërdoret mikrofonin për diçka tjetër, jo për atë që e ke marrë fjalën, nuk do t'i jepet fjala askujt më.

(Reagime nga salla)

(Ndërprerje e incizimit)

Konstatohet se në sallë janë 65 deputetë. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ripranim

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ripranim dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimi e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, Rustem Mustafa apo raportuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, nëse e do fjalën. Fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ripranim është miratuar në lexim të parë, në seancën plenare, datë 28.5.2010 dhe Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri është caktuar si komision funksional për shqyrtimin e këtij projektligji. Ky projektligj, si një ndër kushtet për marrjen e Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, ka kaluar me një procedurë më dinamike, më të shpejtë se projektligjet tjera.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi, përcakton rregullat dhe procedurat për ripranim, ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk përmbush kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e vendit, në territorin e shtetit kërkuar. Për këtë projektligj ka qenë referuese nënkryetaria e komisionit, zonja Suzan Novobrdaliu. Për këtë projektligj komisioni ka mbajtur dëgjim publik, ka caktuar edhe grupin punues dhe ka pasur kontakt me përfaqësuesit e Shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit.

Raporti final me rekomandime për këtë projektligj, i proceduar për seancë, përmban gjithsej 14 amendamente. Komisioni vlerësoi se dispozitat e projektligjit në fjalë, me amendamentet e propozuara ofron një kornizë ligjore lidhur me procedurat e ripranimit. Andaj, komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Prezentë janë 69 deputetë. Në ekran unë e kam prezentë 99 deputetë. Atëherë, ne duhet ta bëjmë që tri herë në ditë të nënshkruhen në fillim të seancës, në mes të seancës dhe në fund të seancës, nëse vazhdon ky keqpërdorim i vendosjes së kartelave pa prezencën e deputetëve. Kjo me të vërtetë nuk shkon. Të gjitha pikat e rendit të ditës kanë të bëjnë me votim. Ne duhet t'i kemi të gjithë deputetët në sallë.

Vazhdojmë votimin. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 50 “për”, 2 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 1.

Armend Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Unë do ta them një vërejtje apo ndoshta do të kërkoj edhe një sqarim nga komisioni funksional rreth amendamentit 2, neni...

(Reagime nga sallat)

KRYETARI: Unë ia jap fjalën atij që dua, fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ... neni 2, pika 11, që do t' thotë të hiqet, ka të bëjë te përkufizimet - të miturit e pashoqëruar, i cili lidhet edhe me amendamentin 7, ku rekomandohet që edhe neni 7 të hiqet. Neni 7, thotë: “Ripranimi i të miturit të pashoqëruar, si dhe persona me nevoja të veçanta”. Kërkoj nga komisioni funksional, nga raportuesi, a e cenon kjo më tutje ripranimin apo e përjashton që personat e pashoqëruar mos të kenë të drejtë në rihyrje apo personat e vendeve të treta, siç quhen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Siç e theksoi edhe kryetari i Komisionit, unë kam qenë referuese për këtë Projektligj. Kemi mbajtur dëgjim publik, kemi pasur shumë propozime lidhur me këtë nen. Një propozim ka qenë që të hiqet neni 7, meqë ky ligj ka të bëjë me ripranimin e shtetasve të Kosovës dhe të shtetasve të huaj. Prandaj, ka qenë një diskriminim që të veçohen vetëm fëmijët, se edhe fëmijët janë shtetas të Kosovës. Për këtë arsye, kemi pasur një propozim prej Komisionit Evropian që të hiqet neni 7, vetvetiu edhe përkufizimi është dashur të hiqet, derisa nga UNICEF-i kemi pasur të mbetet. E kemi

analizuar, e kemi këqyrë dhe në fund kemi vendosur, si komision, ta heqim nenin 7, normalisht edhe përkufizimi në këtë rast është dashur të hiqet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kërkoj falje, zoti kryetar, por këtu ka të bëjë me të miturit e pashoqëruar, nuk ka të bëjë me ndarjen e kategorive, sepse flitet për persona me aftësi të kufizuara, por edhe për të miturit e pashoqëruar.

Nëse ky ligj e rregullon që edhe të miturit e pashoqëruar mundën nën moshën të hynë në këtë kategori të gjithë personave, ne e kuptojmë atë, por si definicion kjo kategori ka tretman atë veçantë në çdo vend në botë. Fëmijët apo të miturit e pashoqëruar nuk lejohen të pashoqëruar t'i ofrohen as kufirit apo daljes së shteteve nga çdo vend. Edhe fëmijëve personal, po të jetë, duhet të jetë i shoqëruar dhe ta plotësojë dokumentacionin ose autorizimin. Tani ata që janë ekspertë dhe merren me këto, i dinë më mirë, por këtu ka të bëjë me të miturit e pashoqëruar.

KRYETARI: Suzan Novobrdali e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALI: Këtë që e theksoi Armendi, e kemi pasur parasysh, e kemi diskutuar në komision dhe kemi ardhur në përfundim i gjithë komisioni, të gjithë anëtarët e komisionit që pikërisht neni 7 të mos rregullohet me ligj, por me akte nënligjore, të cilat do t'i nxjerrë Ministria e Punëve të Brendshme.

KRYETARI: Shkojmë, e votojmë amendamentin e dytë.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 41 vota “për”, 13 “kundër”, 10 abstenime, miratohet amendamenti nr. 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti nr. 3.

KRYETARI: Merrni kartelat. Gjylnaze Sylja, a do për amendamentin 4? Regjia, fjalën deputetes Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryetar, nuk ke të drejtë dhe nuk mundesh kështu t'ia japësh fjalën kujt ty të teket. Unë e kam kërkuar fjalën që në fillim për amendamenti 1 dhe nuk ma ke dhënë fjalën. Je duke bërë sot shkelje drastike të Rregullores....

KRYETARI: Mirë, ju faleminderit! Vazhdojmë.

GJYLNAZE SYLA... edhe në mënyrë parciale po i zgjedh. Për amendamentin 1, e keni nocionin përmbajtësor, thotë: “është i vendit të tretë”...

KRYETARI: ... e kemi votuar, e kemi votuar amendamentin 1.

GJYLNAZE SYLA: ... po gabim e ke votuar.

KRYETARI: Jo, e keni votuar ju, unë jo.

GJYLNAZE SYLA: ... po gabim e ke votuar.

KRYETARI: Vazhdojmë me votim.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti nr. 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti nr. 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 37 vota “për”, 19 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti nr. 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 4 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti nr. 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti nr. 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti nr. 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Me 54 “për”, 1 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti nr. 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 3 “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti nr. 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Me 64 vota “për”, 2 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti nr. 13.

Amendamenti 14, i fundit.

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, 2 “kundër”, 7 abstenime, miratohet amendamenti nr. 14.

Tani votojmë ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Prezentë janë 80 deputetë. Votojmë tash:

Me 64 vota “për”, 2 “kundër”, 9 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ripranim. Ju faleminderit!

Vazhdojmë pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Ministrisë të Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit, të sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Hartimi i këtij projektligji ka filluar në muajin shkurt të vitit 2010. Në përpilimin e këtij drafti kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare në Kosovë, ku interesim të veçantë kanë shprehur përfaqësuesit e ICO-s, të EULEX-it, të CTP-së dhe OSBE-së, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre kanë dhënë rekomandime, të cilat, vlerësuar në bazë të arsyeshmërisë, edhe janë inkorporuar në këtë Projektligj.

Nevoja për këtë projektligj është e madhe për faktin se është një ndër kriteret që Bashkimi Evropian kërkon për të arritur progres në procesin e liberalizimit të vizave.

Projektligji ka për qëllim që të përcaktojë rregullat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit. Projektligji ka gjithsej 13 nene. Kostoja buxhetore e vlerësuar e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të dokumenteve të udhëtimit vlerësohet të jetë prej 7 milionë euro. Kjo kosto buxhetore ndërlidhet me nevojën për avancimin e teknologjisë për pasaporta biometrike, si dhe pajisjet për pasaporta biometrike blanko. Totali i koston të vlerësuar prej 7 milionë euro, sipas viteve, parashikohen:

Viti 2010, viti i parë i ndikimeve buxhetore, kostoja shtesë buxhetore prej 2.5 milionë euro, prej tyre mallra dhe shërbime 1.5 milionë euro, si dhe shpenzimet kapitale prej 1 milion euro.

Viti i dytë, 2011, kostoja shtesë buxhetore prej 2.5 milionë euro mallra dhe shërbime,

Viti 2012, pra viti i tretë, kostoja shtesë buxhetore 1 milionë euro mallra dhe shërbime, dhe

Viti i katërt, viti 2013, kostoja shtesë buxhetore prej 1 milion euro mallra dhe shërbime.

Vlen të theksohet se ky Projektligj krijon të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës. Projektligji ka deklaraten e pajtueshmërisë të Ministrisë për Integritet Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e BE-së.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ, për fushë veprimtarinë të cilën e rregullon nga arsyet e theksuara më lart. Propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës Projektligjin për ndryshim plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit ta miratojë, në parim. Ju faleminderit në vëmendje!

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Nëse e do fjalën kryetari ose raportuesi i komisionit funksional. A e do fjalën? Rrustem Mustafa, urdhëro!

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit!

Sot do të flas edhe në emër të kryetarit të komisionit funksional edhe në emër të grupit parlamentar.

Unë, në konsultim me komisionin dhe me grupin parlamentar, kemi shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe jemi ndier mirë, sepse kanë ardhur, janë plotësuar kushtet që ky ligj të ndryshohet. Ne konsiderojmë që vendi ynë, një varg mekanizmash institucional i ka funksionalizuar dhe me funksionalizimin e tyre tash paraqitet nevoja për ndryshimin e projektligjit. Mua më vjen mirë që sponzorizuesi ka avancuar përpara dhe ka prurë para nesh, ka paraqitur një projektligj më të qartë se herëve tjera, kur është dashur të intervenohet deri më 50 – 60 amendamente. Në këtë ligj dhe në ligjin që posa e miratuar, kemi vërejtur punë më të mirë të Ministrisë, me ç'rast i falënderojmë. Unë e di që do të duhej, meqë është fjala për çështje teknike, në Komision të punohet shumë, edhe në grupin parlamentar ka angazhim për të punua, dhe to ta shqyrtojmë në të ardhmen. Ju faleminderit.

Unë thërras edhe grupin parlamentar, edhe Kuvendin që ta miratojmë këtë projektligj, në lexim të parë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Mustafa! Në emër të LDK-së, unë po e shohë që është paraqitur deputetja Luljeta Shehu. Urdhëro, deputete!

LULJETA SHEHU: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar me kujdes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit dhe mendojmë se Kosova ka nevojë për një ndryshim dhe plotësim, për një ligj që ka për qëllim të sigurojë përputhshmërinë e projektligjit me parimet e përgjithshme themelore të së drejtës së BE-së.

Me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të dokumenteve të udhëtimit paraqiten të gjitha risitë dhe avancimet që konsistojnë në atë që shtetasve të Republikës së Kosovës u mundësohet pajisja me pasaportat biometrike, i cili është njëri prej kriterëve për liberalizimin e vizave me qëllim të qarkullimit të lirë të shtetasve të Republikës së Kosovës. Te ky projektligj shtohet edhe një dokument i ri, që është librezë detare.

Vlerësimi i koston buxhetore 2010-2013, për këtë projektligj vlerësohet të jetë 7.0 milionë euro. Kjo kosto buxhetore kryesisht ndërlidhet me nevojën për avancimin e teknologjisë për pasaporta biometrike, si dhe pajisjen me pasaporta biometrike bllanko. Këto të dhëna për vlerësimin e koston buxhetore nuk paraqesin fakte, por supozime për kalkulime, sepse ky supozim për këtë vlerësim të koston bartë me vete paqartësi dhe rreziqe financiare, sidomos kostoja për vitin 2011-2013 është e lidhur me numrin e shtetasve që do të aplikojnë për t'u pajisur me dokumente të reja.

Ne, si grup, në parim e mbështesim këtë plotësim dhe ndryshim të Projektligjit për dhënien e dokumenteve të udhëtimit dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Shehu! Në emër të AAK-së, kryetari i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Para se të kaloj, të flas për ligjin, do ta bëjë diçka që zakonisht nuk e bëjë, do të flas pak për gjuhën që është përdorur dhe do t'ia marr pak punë profesorit dhe pasi ta kryej këtë farë leximi të gjuhës, do t'ju them pse e bëra këtë punë, do të thotë pse kalova te gjuha.

Nëse e merrni faqen 5, e keni ndryshimin, do të thotë neni 6, ku thuhet: “dokumenti i udhëtimit përmban të dhënat si në vijim”. E kam lexuar disa herë, do të thotë janë tri gjuhët në tri shtylla dhe është shumë interesant kjo punë. Nëse e lexoni në gjuhën serbe ose serbokroate, mendoj se shumica që i kanë mbi 40 vjet, dinë të lexojnë, unë të paktën di, ma merr mendja, nuk ka asnjë gabim. Ju lutem, merreni lexoni edhe nëse dikush e sheh ndonjë gabim, le të më tregojnë, kolegët serbë mund të më tregojnë që është saktë.

Nëse e shihni pjesën te gjuha angleze, është një gabim i përsëritur dy herë, që mund të jetë edhe gabim i lëshuar, thotë në vend se “travel”, “taravel”, dy herë e përsërit, ndërsa nëse shkoni te kolona në gjuhën shqipe, keni për t'u tmerruar. Edhe po ia nisi, edhe po ua lexoj: germat “ë”, diku janë përdorur, diku nuk janë përdorur, te germa “ë” nuk po ndalem hiq, do të thotë, po kemi për shembull fjali, një fjali me tri fjalë që përmbajnë diku nga 6 – 7 gabime, që mund t'i dinë gjuhëtarët më mirë se unë. Për shembull, thotë: “Lloji dokumeti te udhetimit”, mungojnë lidhëzat, mungojnë “ë”-jat, nuk ka kurrfarë sensi, do me thënë, kjo gjuhë nuk e di qysh flitet kështu. Atëherë, thotë: “kodi e dokumentit”, edhe gjinitë mbrapshtohen. Atëherë, vazhdon më tutje, thotë: “Autoriteti i leshimit, data e skadimit te nenshkrimi, fotografina e mbajtjesit”, do të thotë, janë diku nga 40 gabime, nëse i rrumbullakojmë me të kuqe, pa qenë gjuhëtar, që janë në kolonën në gjuhën shqipe. Mendoj se shteti i Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës duhet të sofistikohet, se me të vërtetë nuk merr shumë kohë, i merr diku 20 minuta ose një gjysmë ore për dikë që nuk ka nevojë të jetë ekspert i klasit, për të mos lejuar që dokumentet të na vijnë kështu. Asnjë gabim në gjuhën serbokroate, një gabim në gjuhën angleze, nga 40 gabime në gjuhën shqipe.

Pse është me rëndësi kjo, pse po e përsërisim? Është me rëndësi se qysh mund të besojmë ne që dikush në Qeveri të Kosovës ka punuar aq shumë dhe me aq kujdes në ligj, kur nuk ka mbërri mbas shumë leximeve, të na sjellë një dokument, të paktën që shkon deri kah minimumi i gabimeve në gjuhën shqipe dhe, në fund të fundit, unë jam një shqiptar edhe po më vjen pak inat t'i kemi gjuhët tjera në dokument pa asnjë gabim, e në gjuhën shqipe me maksimum të gabimeve. Është hera e pesëmbjete që jemi duke e përsëritur këtë temë.

Tani po kaloj te ligji. Kemi dëgjuar që prej institucioneve të EU-së është kërkuar që të mos e bëjmë një gjë të tillë, të mos e ndryshojmë ligjin dhe në vend se të na tregojnë sa nene, me gjithë respektin, ministri ka qenë dashur që politikisht të na tregojë pse ka kërkuar EU që të mos e bëjmë këtë punë dhe pse ne po e bëjmë, domethënë çka ka këtu në mes, mos ta lëmë Kuvendin të ketë dilema se çka të bëjmë ne. Se, në fund të fundit, ne vendosim politikisht për ligjin dhe ne duhet ta dimë pse ministri dhe Qeveria kanë vendosur ta kalojnë këtë ligj, le që në fund të fundit, po ju them, Grupi i Aleancës e mbështet, mirëpo të na tregohet pak më shumë, të dimë ne mos të biem në lajthitje për diçka tjetër.

Nëse është e vërtetë që është kërkuar me shkrim që të mos bëhet, të na tregohet pse është kërkuar dhe pse përkundër kësaj kërkesë, Qeveria e Kosovës ka vendosur ta kalojë këtë ligj.

Çështje tjetër, e dyta, që ka të bëjë me ligjin është kjo, te buxheti. Ministri e përmendi cilat janë implikimet buxhetore. Po ju them diçka, ne tash duhet ta rishikojmë buxhetin për këtë ligj. Përderisa vitin e kaluar, para rishikimit të vitit të kaluar, do të thotë para se të aprovohet jo vetëm buxheti për këtë vit, por edhe para rishikimit, ne kemi dëgjuar prej Qeverisë të na thuhet se Qeveria e ka prioritet implementimin e të gjitha kriterëve për liberalizim të vizave në mënyrë të një anshme, do të thotë, bile është thënë “ne do t’i përmbushim në mënyrë të njëanshme kriteret për liberalizim të vizave”. Tani, nëse një Qeveri e ka synim ta kryej një punë, qysh mundet të mbërrijë të mos e fusë në buxhet, do të thotë qysh mund ta implementojë një politikë të Qeverisë, të cilën e ka paraqitur publikisht si politikë reale të veten dhe të mos e parasheh në buxhet. Edhe nëse të paktën është paraparë më herët, pse i ka ra ndërmend Qeverisë kaq vonë të vijë me këtë propozim dhe të duhet krejt kohën të rishikojmë ne, do të thotë, thua se po zgjohet dikush në mëngjes dhe po i bie ndërmend të bëjë diçka dhe atëherë ne po vijmë dhe po duhet të rishikojmë buxhetin për gjithçka.

Mendoj se qeveritë serioze parashohin pak më shumë se një vit përpara, e lëre më dy, tre ose katër muaj më përpara. Në lidhje me këtë thuhet që vetëm më 2010 duhet rishikuar, do të thotë duhet gjetur diku 2.5 milionë euro, që do me thënë Qeveria i ka diku tepriçë 2.5 milionë euro ose duhet t’ia heqin një projekti të cilin e ka votuar Kuvendi më përpara, se aty nuk janë një arkë pa lidhje ato të hollat e buxhetit, janë të ndara, e dini mirë, të gjithë jeni deputetë, janë të ndara saktë ku shkojnë. Ku donë t’i marrin, Kuvendi duhet ta dijë tash, nëse e votojmë këtë ligj, ne duhet ta dimë ku do t’i marrë Qeveria këto 2.5 milionë euro, sepse kanë marrë prej rishikimit, e ndoshta Kuvendi nuk është i interesuar të lejojë që Qeveria t’i heq, shembull ta marrim, mjetet prej pensioneve, ky është digresion, dhe t’i qisë në çështje të pasaportave. Do të thotë, në krejt dokumentin që e kemi marrë për buxhet, në çdo vend serioz Qeveria duhet t’i tregojë Kuvendit, i cili e ka miratuar buxhetin, se ku do t’i marrë 2.5 milionë euro, edhe nëse jemi për, që në esencë jemi.

Tani për t’u ndalur këtu, te kjo pikë e buxhetit, unë po ua lexoj juve pikën 4 të Deklaratës për buxhet, se çka thotë: Paqartësi, rreziqe fiskale - e ka titullin, thotë kështu: “të dhënat që i keni marrë për vlerësimin e kostos buxhetore, nuk paraqesin fakte, por supozime për kalkulim, andaj ky supozim për këtë vlerësim të kostos bartë në vete paqartësi dhe rreziqe financiare, si dhe shkallë të lartë pasigurie dhe paqëndrueshmërie edhe me vetë faktin s një pjesë e kostos së vlerësuar, sidomos kostoja që ka të bëjë me vitin 2011-2013, është i lidhur me numrin e shtetasve që do të aplikojnë për t’u pajisur me dokumente të raja”, do të thotë është diçka krejt e paqëndrueshme. Thotë, i vetmi Agjencion i Qeverisë, Ministria e Financave i thotë Qeverisë se ke shumë paqartësi në lidhje me buxhetin, dhe tash Kuvendi, domethënë ne, duhet t’i lexojmë krejt këto dhe të vendosim, të votojmë “për” ose “kundër” për diçka që Qeveria vetë na sjellë paqartësi neve. Në kushte normale, Qeveria nuk duhet të na sjellë ne kesi dokumenti, se Ministria e Punëve të Brendshme edhe Ministria e Financave, duhet diskutuar nëse është nevoja njëqind herë, që kur të vijë këtu të na tregojnë saktë ku duam t’i marrim paratë. Kur ta bëjmë rishikimin, pas aprovimit të këtij ligji, në momentin që e aprovojmë këtë ligj, jemi të obliguar të kemi diçka me rishikim të buxhetit, se përndryshe nuk implementohet ligji. Ku duam t’i marrim, pse janë këto paqartësi?

Mendoj se përkundër faktit se na duhet ky ligj, përkundër faktit se politikisht e mbështesim, vetë ardhja e këtij ligji në këtë mënyrë, e di që ministri nuk ka qenë në atë kohë ministër kur ka filluar të përgatitet kjo punë, tregon një mos seriozitet në qasje. Edhe një herë po e them, nëse i lexojmë të gjitha këto bashkë, e shohim se dikujt i ka ra ndërmend ta kryej këtë punë edhe ka thënë – kryeje shpejt dhe është kryer puna shpejt dhe, në fund të fundit, Kuvendi duhet t’i shohë këto paqartësi buxhetore. Nuk dimë ku donë t’i marrin mjetet. Merri ku të dush, nuk është me rëndësi a janë

implementuar projektet që i kemi votuar ne, buxheti është ligj. Nëse ne e kemi votuar buxhetin, atëherë ku donë t'i marrin 2.5 milionë në këtë vit. Cilin projekt që e kemi votuar ne, Qeveria nuk e ka implementuar, nuk është duke e zbatuar, cilën pikë?

Në fund të fundit, edhe një herë po kërkoj që të ketë koordinim më të mirë në mes të institucioneve të Qeverisë për shkak se si një shtet, i cili është i jashtëzakonshëm, që dëgjuam në fillim këtu, nuk bën, nuk kanë të bëjnë me shtet të jashtëzakonshëm, këto kanë të bëjnë me një shtet, i cili nuk ka mbërri as minimumin e koordinimit në mes institucioneve të shtetit, me gjithë respektin për ministrin.

Në fund të fundit, si kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës, nuk kam qysh mos ta përmend se kryetari i Kuvendit sot ka thënë: “ia jep fjalën kujt të dua”. Kërkoj kjo të jetë në transkript, të mbahet në mend për një kohë pak më të gjatë, se kur kryetari i Kuvendit deklaroi publikisht që ia jep fjalën kujt të dojë, ne kemi të bëjmë me diçka tjetër e jo me demokraci. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, jo s'bën. Kur të vjen koha, i bën sqarimet!

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Ty të kanë thënë, po priti deklaratimet e grupeve parlamentare dhe do ta marrësh fjalën, s'ka problem. Ti e ke paraqitur ligjin dhe përgjigjesh në fund. E ka fjalën Riza Smaka, për AKR-në.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Në parim, disa vërejtje kështu ekzistente. Aktet tona ligjore që i miratojmë, u mor vesh se po i miratojmë do si do e shkel e shko dhe çka po ndodh, po duhet të bëjmë amendime të shpeshta dhe të shumta. Këto edhe na kushtojnë dhe gjithçka. Tri pika, domethënë ka shumë fjalë për këtë.

Dy, atë që e tha zotëri Gjini, qëndron, është çështje paraparake, është dashur të specifikohet burimi i mjeteve financiare, i cili do ta siguronte implementimin e këtij dokumenti kur do të miratohej.

Dhe, tre, jo sipas rëndësisë, por radhës të rastit. Terminologjia, akti ligjor në qoftë se vuan terminologjikisht, nuk mund të jetë akt ligjor. Praktikisht s'mund të jetë akt ligjor ose ne mund ta quajmë, por nuk mund ta ushtrojë funksionin elementar të aktit ligjor. Me të vërtetë ka gabime të shumta. Nuk ia vlen për t'i përfolur, se në çdo fjali apo aline ka. Ajo çka është më brengosëse është që, po e zëmë, pa fije dyshimi del, kjo rezulton se ai, ajo, ata apo ato që e kanë hartuar këtë dokument, kanë përtuar që ta lexojnë së paku një herë, ta lexojnë edhe një herë dhe ta unifikojnë. Këtu s'ka... nuk janë 1.000 faqe, 4-5 faqe. Po e zëmë, termi i njëjtë përdoret me emërtime të ndryshme, herë listë e udhëtimit, herë dokument i udhëtimit, herë fletë udhëtimi. Kjo është edhe në shqip, siç tha zotëri Gjini, në anglisht ka më shumë se një gabim, që janë në fillim. Ju lutem – on travel document, është dashur së paku të thuhet documents, e kështu. Ka gabime të tilla edhe në serbisht, po e zëmë, herë thuhet – putni list, herë – putna isprava, për të njëjtin dokument. Nuk është fjala për një akt ligjor që është kod, po e zëmë civil, a penal, a administrativ.

Më pastaj, është ngritur kjo çështje, është miratuar unanimisht pikërisht në Kuvend, që nuk duhet të thuhet “nënkupton”, po librezat detare jo nënkupton, por është dokument, e tutje, e më tutje.

Ose po e zëmë, te alineja 3 e nenit 1. Ndër të tjera, “... që ndërrohet për një afat të caktuar kohor”. Nuk bën të ndahet emri dhe mbiemri, por për një afat kohor të caktuar, se e krijon një pakënaqësi për lexuesin. Ja konkretisht, neni 5, neni 6, herë dokumenti i udhëtimit, herë fleta e udhëtimit.

Ose neni 6, paragrafi 2. “Dokumenti i udhëtimit përmban të dhënat si në vijim”. Një shprehje je paqëndrueshme, në vend që të thuhej “dokument i udhëtimit përmban këto të dhëna:” dhe më pastaj t’i përshtatet, edhe këto të dhëna: emrin e shtetit, jo emri i shtetit, se nëse thuhet - këto të dhëna, nuk thuhet emri (njëjës) po emrin e shtetit, llojin e jo lloji i dokumenti të udhëtimit e kështu me radhë.

Ose, te neni 12, paragrafi i dytë. “Dokumentet e udhëtimit e lëshuara”. Duhet të jetë - të lëshuara, se këtu po fitohet një përshtypje që hartuesit nuk e kanë gjuhë amtare gjuhën shqipe. Kjo është elementare, duhet ta ketë një sens elementar në vesh, që nuk thuhet shumësi “e lëshuara”, por “të lëshuara”. Ose bie fjala, “ky ligj hyn në fuqi”. Këtu duhet “L” i madh, germë e madhe, se është fjala për këtë ligj.

Ose te neni 7, paragrafi 2. “Formularët dhe dokumentet e udhëtimit të papersonalizuara shtypen sipas....” me germa të vogla thuhet “ligjit për përdorimin”, këtu “gjuhëve” me të madhe, e tjera. Ligji për..., me germë të madhe, se është fjala, është nocion i individualizuar.

Ne, në parim kështu, në përgjithësi, hiq këto vërejtje parimore dhe mund të thuhet deri diku edhe substanciale aty-këtu, ne e mbështesim këtë plotësim dhe modifikim të këtij dokumenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për LDD-në, kush flet? Deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë për një projektligj shumë të rëndësishëm që është një nga kriteret teknike, po edhe të përmbushjes së infrastrukturës ligjore të nevojshme për procesin jashtëzakonisht të rëndësishëm të liberalizimit të vizave.

Zoti ministër Rexhepi, Ligji për ripranim, që e mori miratimin formal nga ky Kuvend, besoj që do të jetë një bazë e mirë që të shkohet tutje me hapa tjerë të miratimit të ligjeve që kërkohen në mënyrë strikte dhe këtu nuk ka kompromise, nën një.

Nën dy, Qeverisë së Republikës së Kosovës i ka ardhur një letër nga komisionerja për çështje të brendshme të Bashkimit Evropian që mos të procedohet me prodhimin e pasaportave biometrike dhe kjo u bë temë dite dhe gjatë vizitës së fundit që ishim në Bruksel, një pjesë, një numër i madh i deputetëve, do të thotë, sfidat që të plotësohen këto kriterë, qoftë në aspektin e menaxhimit të kufijve, të bashkëpunimit regjional, po edhe të përmbushjes së kriterëve tjera që janë thjeshtë teknike dhe ne nuk jemi askund në atë trend, janë shqetësim për qytetarët e Kosovës, po edhe për ne, si deputetë. Në qoftë se nuk ka një koordinim, një akordancë të plotë në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe mekanizmave relevantë të Bashkimit Evropian, që janë kompetent për këto çështje, atëherë si mund të procedojmë.

Dhe tani dua të kthehem te ligji. Ligji është i hartuar, vërtet po ta hartonin një dy maturanta në aspektin e teknikave juridike, të përmbajtjes gjuhësore e të tjera, do të ishte një ligj më serioz. Ju lutem, është një ligj tejet i rëndësishëm dhe po e sjell Qeveria e Republikës së Kosovës. Atëherë, ky Kuvend po sfidohet. Kemi staf, kemi ekspertizë, kemi administratë dhe a i lexon dikush këto ligje që iu vijnë dhe iu sillen përpara deputetëve të organit më të lartë të organit legjislativ të vendit. Që disa herë një numër i madh i deputetëve nga të gjitha grupet politike po e potencojnë këtë.

Ne i kemi shqetësimet tona, si Lidhje Demokratike e Dardanisë, të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sepse ky projektligj që të implementohet plotësisht, nevojiten 7 milionë euro dhe ende nuk jemi të

sigurt kjo përlllogaritje a është precize apo jo, apo do të dalin edhe miliona euro të tjera në procedurat kur do të fillojë ky proces i prodhimit të pasaportave biometrike.

Për vitin 2010 parashihen 2.5 milionë euro, të cilat Qeveria nuk di se ku do t'i marrë, apo do t'i marrë nga projektet e tjera, qoftë të investimeve kapitale apo edhe alokime tjera për destinime të tjera të organizatave buxhetore dhe në njëfarë forme çka do të lihet keq pa u implementuar nga projektet dhe dinamika e implementimit të investimeve kapitale që i ka paraparë Qeveria hiq më larg se para 7-8 muajve, në dhjetor të vitit që e lamë pas, që e miratuam Buxhetin e Republikës së Kosovës. Dhe atëherë parashtrohet pyetja, kjo Qeveri a ka njerëz që e bëjnë planifikimin buxhetor, a mendon dikush për planifikim buxhetor dhe pse sillen ligje të rëndësishme, ky ligj është i rëndësishëm, ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe ne në parim do ta mbështesim, ministër, ama kemi obligim para qytetarëve dhe opinionit, por edhe si njerëz të zgjedhur që, thjeshtë, këto shqetësime tona të merren parasysh, sepse nuk është hera e parë. Ministria e Ekonomisë dhe Financave përmes këtij vlerësimi të ndikimit buxhetor në njëfarë forme bën alarm që ky projektligj të presë, të analizohet më mirë, të bëhet një planifikim buxhetor dhe të shihet tutje se si të procedohet, sepse parasheh paqartësi dhe rreziqe fiskale dhe buxhetore për implementimin e këtij projektligji.

Tani jemi në kohë të pushimeve dhe kur e bëjmë krahasimin me dokumentet e udhëtimit, azhurnimin e regjistrimit civil, mos procedimin e shërbimeve konsullore në ambasadat tona dhe shërbimin diplomatik, zoti ministër, me të madhe trumbetojnë qeveritarët e të gjitha niveleve se do të fillojmë këtë ditë ose atë ditë dhe mërgimtarët tanë, tani që është kohë pushimesh, do të vijnë në Kosovë, ende as që ishte gati, e vizituam Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel para dy dite dhe ata njerëz janë të shqetësuar me të gjitha natyrat logjistike, financiare dhe mos të flasim për Shërbimin konsullor, që nuk është askund, dhe duhet ta dinë qytetarët e Kosovës dhe mërgimtarët që pa marrëveshje me Ministrinë e Jashtme të atij vendi nuk ka fillim të shërbimeve konsullore dhe kur të fillojë edhe ky proces, frikojmë se do të bëhet mish-mash i vërtet, sidomos me qindra mijëra njerëz që i kemi në mërgatë dhe tani, po të fillojmë sot në prodhimin e pasaportave biometrike, kjo kërkon kohë, kërkon shpenzime. A jeni të bindur se është bërë azhurnimi i plotë dhe spastrimi i regjistrimit civil? Jo. Kemi shembuj të vendeve në rajon. Shqipëria këto çështje i ka rregulluar për 6 muaj, por i ka angazhuar institucionet më profesionale, mekanizmat tjerë, në bashkëpunim edhe me miq ndërkombëtarë, por edhe me ekspertizën e vendeve që i kanë kaluar mirë këto procese jo të lehta dhe në bashkëpunim të plotë me mekanizmat e Bashkimit Evropian. Pse të mos jemi në akordancë të plotë edhe ne, si Parlament, që po ia japim dritën jeshile këtij ligji, por edhe Qeveria le t'i kryejë punët e veta. Dhe nëse vazhdojmë kështu me ligje të tilla të rëndësishme që e prekin direkt cilësinë e jetës së qytetarit, lëvizjen, nevojat e qarkullimit, atëherë frikoj se të gjitha këto gjëra do të hasin në një rrugë pa krye. Andaj, zoti ministër, është detyrë ekskluzive e juaja dhe e Qeverisë së Republikës së Kosovës që njëherë e përgjithmonë këto gjëra t'i spastrojë, t'i adresojë dhe artikulojë si duhet, por edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave njëherë e përgjithmonë duhet të vijë me vlerësime të qarta dhe me planifikim buxhetor ashtu siç duhet. Unë frikoj se do ta fillojmë këtë proces, do të na hasë sharra në gozhdë, si dhe herëve tjera me projektligje dhe ligje të caktuara dhe do të biem shumë joserioz si popull dhe si institucione para mekanizmave të Bashkimit Evropian. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Enis Kervan, për Grupin “7+”

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Bu Yasa tasarısıyla birlikte, değişmelere ilişkin olan Seyahat Belgeleri Yasasının incelemesi grubumuz tarafından yapılmıştır. Bu Yasa tasarısı, seyahat belgeleriyle ilgili Avrupa kriterleriyle uyum içindedir. Bu Yasa taslağı, Kosova ve onun vatandaşlarının geleceği için faydalı olabilecek yasaların Avrupa kriterlerine göre uyumlaştırılması yönünde büyük önem taşımaktadır.

Ancak 7+Parlamentar grupu olarak, sözkonusu Yasa tasarısı hakkında bazı uyarılarımız vardır.

Yasa tasarısının 7. maddesi, seyahat belge ve evraklarının hangi dillerde basılması gereğini düzenlemektedir ve Dillerin kullanımı Yasasına atıfta bulunmaktadır. Ancak bu değişiklik, var olan yasayla çelişki içindedir. Çünkü hala yürürlükte olan Seyahat Belgeleri Yasasının 15. maddesine göre, Kosova Cumhuriyeti seyahat belgeleri, Kosova Cumhuriyeti resmi dillerinde ve belediyelerin resmi dillerinde, dolayısıyla Arnavutça, Sırpça, Türkçe ve Boşnakça basılmalıdır. Yürürlükteki yasada var olan bir hakkın, yeni düzenlenen yasayla kısıtlandırılması kabul edilmez bir girişimdir.

Bu nedenle yasa taslağının diller bölümüne ait 7. maddesinin ya tamamen kaldırılması, eski 15. maddenin olduğu gibi kalması, ya da Diller Yasasının 2. maddesine göre olmalıdır. Ancak bu şekilde var olan yasal hakkımızın konumu korunacaktır.

İlginize teşekkürler

KRYESUESI: Faleminderit! Petar Miletqi, për Grupin e SLS-së!

PETAR MILETIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Poštovani ministri,

Kolege poslanici,

Mene je diskusija gospodina Gjinija motivisala da i ja kažem nekoliko reči o jeziku koji se upotrebljava u ovoj Skupštini i u zakonima koji prolaze kroz naše ruke.

Ovaj današnji Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o putnim ispravama i nije tako loš što se tiče korišćenja srpskog jezika. Međutim, mnogi zakoni koji su nam prošli kroz ruke su bili u jako lošem stanju što se tiče jezika. Ja znam da su nekada prevodioci u teškom položaju zato što im se da zakon da ga prevedu u nekom kratkom roku i oni u žurbi naprave neke greške.

Međutim, još juče kada sam čitao Nacrt zakona o ponovnom prihvatu sam odlučio da u našoj poslaničkoj grupi predložimo Predsedništvu Skupštine da se u Skupštini zaposli lektor, odnosno ako već postoji, da se zaposli još jedan, jer neki zakoni koji su prošli kroz moje ruke i koje sam čitao su prosto zločin nad srpskim jezikom. I mi do sada nismo zaista reagovali na ovakve stvari jer smo hteli da budemo praktični i pragmatični, znajući da često žurimo sa nekim zakonima da bi smo ispunili neke rokove, međutim zaista ćemo morati da reagujemo na ovo jer kod nekih zakona čak se i suština menja zbog jezičkih grešaka.

U ovom zakonu sam našao jednu grešku koja može da promeni suštinu a to je u članu 9. Kaže, gde se pominju „utisci prstiju“. Utisak je nešto drugo, pretpostavljam da se radi o „otiscima prstiju“. Dakle, druga je reč u pitanju, jer svi znamo da se radi o otisku i naravno da ćemo mi glasati za ovaj nacrt zakona, nećemo zbog ove jezičke greške da ne podržimo zakon, ali prosto, to će biti naša inicijativa da se u Skupštini zaposli lektor za srpski jezik.

Ono što ćemo mi kroz Komisije da damo svoj doprinos ovom Nacrtu zakona o izmenama i dopunama se tiče člana 7. a to je kada je u pitanju pismo i podržaćemo naravno naše kolege iz Turske zajednice koji traže da isprave budu u onim opštinama gde su oni većina, odnosno tamo gde žive, gde je njihov jezik u upotrebi da bude na njihovom jeziku. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Isto smo mi pažljivo razmatrali Zakon o putnim ispravama. Mislimo da je dopuna ovog zakona neophodna. Međutim, kada je u pitanju, isto podržavamo u potpunosti kolegu Enisa Kervana, što bi još dodala da se na isti način neke stvari kada su obnovljivi zakoni, kada se ponovo daju članovi da se krše prava pojedinih zajednica, mi znamo da je naše područje... moramo da znamo da je 1974. godine turski jezik bio jezik koji je imao isti status sa srpskim i albanskim jezikom. Ako danas ta zajednica, ako je izgubila to pravo na centralnom nivou, ne smemo da dozvolimo da to bude na lokalnom nivou, zato što se putne isprave izdaju od strane Ministarstva unutrašnjih poslova. Znači, putne isprave se izdaju u lokalnoj samoupravi. I ne može ovaj član 7. čitam: „Član 15. zakona izmenjuje i dopunjava se kao u sledećem: “Obrasci i putne isprave ne personalizovane štampaju se prema Zakonu o upotrebi jezika u Republici Kosovo“. Zakon o upotrebi jezika u Republici Kosovo znamo da je po članu 3. srpski i albanski. Ja apelujem da se ovo više ne dešava, da li je namerno ili nije, ja sam jedna od poslanica koja se borim da ista prava imamo svi. To je jedno.

Drugo, čak moći ćemo kao svi ostali poslanici da vratimo status turskog jezika. Verujte mi, ja ću da radim na tome da se vrati status turskog jezika na centralnom nivou. Jedno.

Drugo, što je jako važno, hoću da dam, mi znamo da će biti izdavanja biometrijskih pasoša, hoću da dam do znanja kao grupa, da se analizira od strane svih ministarstva unutrašnjih poslova na lokalnom nivou da se vidi koliko je pasoša izdato i ako to bude bilo zbog liberalizacije da moramo da imamo biometrijske pasoše sa biometrijskim elektronskim čepom, molim da se isti građani ne izlažu ponovo troškovima oko izdavanja pasoša, da se ispoštuju, jer znamo da je na terenu uveliko izdavanje pasoša, i iste svoje građane dva puta i ovo faktički i dajemo im dva puta da plaćaju istu stvar. Ja to isto molim zato što je standard naših građana jako nizak i da se ovo zakonski podrži. Toliko od naše grupe. Mi ćemo ovaj zakon da podržimo, znamo da nam putne isprave trebaju i jako nam je potrebna vizna liberalizacija i moramo, nema velike budžetske implikacije, čak će imati i prihode koji će biti revidirani i realizovani na lokalnom nivou, te smatram da ovo nije neka budžetska implikacija kada treba da dobijamo svoj identitet u svetu i u Evropi gde nam je zajednički cilj. Toliko od naše grupe. Hvala na razumevanju!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne dëgjuam deri më tash deklaratat për ligjin, deklaratat e grupeve parlamentare. Të gjithë në princip do ta votojnë, thanë. Ju njoftoj që kemi të paraqitur për diskutim edhe 8 vetë dhe këta janë Gjylnaze Syla, Shkumbin Demalijaj, Nekibe Kelmendi, Ramadan Avdiu, Gani Buçinca, Synavere Rysha, Radmilla Vujoviq dhe Bujar Dugolli. Në princip, ministri e merr fjalën në fund. Megjithatë, ka insistuar pas dy-tri vërejtjeve të grupeve dhe unë do t'i jap fjalën ministrit, shkurt. Urdhëro, në këtë fazë, më shkurt!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht ju falënderoj që në parim e mbështetni një projektligj të një natyre dhe rëndësie të veçantë, përkundër shqetësimeve që i shprehët dhe ndoshta edhe gabimeve që janë në këtë projektligj. Mendoj se edhe zoti Gjini dhe zoti Rugova e ngritën një shqetësim, që është shqetësim edhe i gjithë qytetarëve. Bashkimi Evropian ka shprehur shqetësimet se a do të jemi të gatshëm të përgatisim regjistrin civil deri në kohën kur të fillojë prodhimi i pasaportave biometrike. Kjo na është thënë edhe gojarisht me zotëri Štefan Füle, gjatë vizitës së tij dhe mund t'ju konfirmoj sot se na kemi thënë në një afat prej 6 muajsh do ta kompletojmë këtë regjistr civil. Tani, pas një vizite që Agjencioni i regjistrimit civil, një delegacion i gjerë i Teknologjisë Informative kanë shkuar në Shqipëri, kemi ndihmën e tyre, ata konfirmuan se jo 6 muaj, por për 4 muaj do të përmbyllet kjo, kështu që ajo do të mundësojë që procedurat e tenderimit të vazhdojnë dhe ne kemi thënë se kah fundi i vitit do të fillojë prodhimi i pasaportave biometrike. Kemi kërkuar që të shkojmë në dy binarë, në mënyrë paralele. Këtë do ta

dëshmojmë gjatë vizitës që e kemi në Bruksel më 29 dhe 30, te zonja Malstrom dhe besoj se s'do të ketë probleme në atë drejtim. Pra, kjo do të kryhet ashtu si kemi premtuar.

Sa iu përket çështjeve buxhetore, natyrisht janë shqetësimet. Më herët ka qenë një udhërrëfyes i përpiluar në bazë të udhërrëfyesve zyrtarë të shteteve në regjion. Kanë punuar shumë në këtë drejtim, mirëpo tash punohet me dinamikë të shtuar, prandaj ne kemi propozuar se mund të fillojmë sivjet prodhimin e dokumenteve. Natyrisht që çdo qeveri i cakton prioritetet e veta në bazë të Ligjit për menaxhimin e parasë publike, por ndodh që gjatë rishikimit e cakton një prioritet mbi prioritetet tjera dhe natyrisht që Ministria e Ekonomisë dhe Financave do ta gjejë formën se si të mbulohen, sidomos për vitin 2010, ku ka nevojë edhe për pajisje dhe për shërbime e mallra dhe mund të them se ne do të kemi të hyra, gjenerime si e përmendi zonja, nuk mund të flas për shifra, por do të ketë më tepër të hyra se sa harxhojmë për këtë shumë prej 7 milionë në 3-4 vitet e ardhshme dhe natyrisht që ne nuk mund të përcaktojmë tash detajisht se sa do të jenë ato harxhime për arsye se, varësisht nga kërkesa e qytetarëve për pajisje me këto pasaporta, aq edhe do të lëshojmë pasaporta.

Një shqetësim që u përmend, pasaportat ekzistuese do të kenë validitet. S'do të jetë obligim prej momentit kur prodhohen pasaportat biometrike që çdo qytetar të pajiset me to, vetëm ai që do të udhëtojë në shtetet e Bashkimit Evropian, prandaj nuk do t'i nënshtrohen ndonjë obligimi financiar ata që s'kanë arsye të udhëtojnë.

Dhe, krejt dy fjalë për atë që zoti Smaka dhe tjerët i ngritën, çështja e përdorimit të gjuhës është një sëmundje e vjetër, që fatkeqësisht vazhdon edhe më tutje. Ne nuk kemi kapacitete të mjaftueshme ta pastrojmë ose për shkak të rrogave të ulëta ose formave tjera, por nëpër komisione të ndryshme ju shpeshherë keni intervenuar dhe keni pasuruar me fjalë më adekuate dhe e dinë edhe zoti Smaka, që e përmendi dhe të tjerët, se asnjë shtet nuk i bën të gjitha ligjet vetanake, por zakonisht kopjohen nga shtetet tjera, adaptohen, bashkëpunojnë me shtetet tjera dhe na kemi një obligim që t'i kemi me *acquis communautaire*, shpesh janë të përkthyer, unë nuk e mohoj. Vetëm disa ligje që janë shumë specifike, të një natyre specifike për një shtet, prej fillimi përpilohen nga ekspertët tanë, përndryshe të gjitha shtetet...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Kryeje!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: E kreu... kështu që ju falënderoj edhe një herë që në parim po e mbështetni. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Gjylnaze Syla!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit synohet lëshimi i dokumenteve të udhëtimit të sigurisë së lartë, pra pajisja e shtetasve të Republikës së Kosovës me pasaporta biometrike me çip, që është një ndër kriteret për liberalizimin e vizave. Risi në këtë propozim është shtimi i dokumentit të ri – Librezës detare, kurse institucionet kryesore të cilat do të jenë bartëse të zbatimit të këtyre ndryshimeve janë Ministria e Punëve të Brendshme, por edhe ajo e Jashtme.

Sa i përket asaj se sa është në harmoni me BE-në, unë i kisha përmendur 3 rregullore të cilat BE-ja i ka në këtë fushë dhe këto janë: Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Nr 444/2009 për ndryshimin e Rregullores së Këshillit 2252/2004 për pasaportat, Rregullorja tjetër ka të bëjë për vizat,

që është Nr 1683/95 dhe Nr 334/2002 dhe Rregullorja EC Nr 1030/2002 për leje të qëndrimit. Këto i përmenda duke marrë parasysh se disa nga standardet që i ka BE-ja janë të përfshira në këtë plotësim-ndryshim të ligjit, por janë disa mangësi dhe unë kam vërejtje konkrete lidhur me këtë.

Konsideroj se në këtë ndryshim dhe plotësim të Projektligjit duhet të ekzistojnë edhe rregullat për mbrojtjen e fëmijëve gjatë kalimit të kufijve të jashtëm të shtetit. Tjetër, duhet të jenë dispozitat për persona të cilët përjashtohen nga kërkesa e dhënies së gjurmëve të gishtërinjve dhe këtu po e përmendi se si e ka BE-ja të rregulluar. Do të thotë, përjashtohen fëmijët nën moshën 12 vjeç, personat të cilët fizikisht e kanë të pamundur që të bëjnë dhënien e shenjave, gjegjësisht të gjurmëve të gishtërinjve, pastaj rastet kur gjurmët e gishtërinjve nga gishtat e caktuar nuk është e mundur të merren, se është përkohësisht e pamundur, atëherë duhet të lejohet marrja e shenjave nga gishtërinjtë tjerë. Po ashtu, kur nuk është e mundur kjo të bëhet, atëherë duhet të lejohet nxjerrja e një pasaporte diku brenda 12 muajve ose më pak.

Një çështje shumë e rëndësishme në këtë propozim duhet të jetë karakteristika shtesë e sigurisë dhe kërkesat, duke përfshirë fuqizimin e standardeve kundër falsifikimit. Mendoj që duhet pasur një dispozitë lidhur me standardet kundër falsifikimit.

Vërejtje të veçanta kam në nenin 6, i cili ndryshon plotësisht nenin 14 të Ligjit ekzistues. Pika 14.2.18 në të cilën është nënshkrimi, nuk definohet se cili nënshkrim. Duhet të definohet qartë se duhet të jetë “nënshkrimi i personit të autorizuar dhe bartësi i dokumentit të udhëtimit”.

Zoti ministër, unë kisha për të qenë e interesuar, pasi që dhatë sqarimin lidhur me dilemën time për letrën që e keni marrë nga komisionerja, tash për qytetarë të Kosovës a mund të na tregoni se sa do të jetë çmimi i një pasaporte ose dokumenti të udhëtimit?

Një çështje tjetër që është me rëndësi, është sigurimi i buxhetit, ashtu që ligji të gjejë zbatimin e vet. Në qoftë se duhen 7 milionë dhe sipas Kornizës afatmesme 2010 – 2012 janë të siguruar 4.120.000 euro, që do të thotë se duhet shtesë tjera prej 2.879.000 euro. Si keni menduar të siguronit këtë shumë të parave të nevojshme për zbatimin e ligjit?

Për shkak të rëndësisë që ka ky projektligj, sidomos duke marrë parasysh se është një nga kriteret për të siguruar lëvizjen e lirë të shtetasve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian, në parim e përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputeti Shkumbin Demaliaj, të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Pjesëtarë tjerë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Sot kemi këtë plotësim-ndryshim për Ligjin për dokumentet e udhëtimit. Dihet, me daljen e pasaportave, me nxjerrjen e pasaportës së Republikës së Kosovës, si dokument udhëtimi, shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, të them 90% nga dëshira e flaktë që ta kenë dokumentin, vitin e kaluar dhe menjëherë pas dalje së këtij dokumenti dhe nxjerrjes së këtij ligji më herët, e kanë, e posedojnë këtë pasaportë, përpos shumë qytetarëve tanë që janë në diasporë dhe sot përballen me ato probleme që kanë ambasadat, siç e tha zoti Rugova më herët, për shkak se mungojnë aktet tjera të nevojshme që ka nxjerrë Ministria, edhe pse buxheti është ndarë edhe vitin e kaluar, sa ka kërkuar Ministria e Punëve të Jashtme, iu ka ndarë buxheti dhe i gjithë ai buxhet ka kaluar në suficit dhe sot

ambasadat dhe zyrat tona konsullore nuk plotësojnë asnjë kriter për t'u dalë qytetarëve të Kosovës në ndihmë në vendet ku veç i kemi tash të vendosura ato ambasada dhe zyra konsullore.

Unë jam tepër i shqetësuar lidhur me kërkesën që bëhet. Nuk na duhet besoj për momentin të nxjerrim një lloj pasaporte biometrike, sot në të gjitha ato faqet e gazetave është edhe kryetitull: Pse nuk del në tender publik çështja e pasaportës biometrike? Është pra një shqetësim i madh. Ne kemi edhe ligje tjera, por në kuadër të këtij harmonizimi ne na mungon një diçka shumë e madhe, që është standard për BE-në, që nuk mund të funksionojë kjo pasaportë edhe pas një viti edhe në qoftë se me të vërtetë Bashkimi Evropian do të ndikojë te liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, ne kemi një problem shumë të madh, që jo vetëm ato shifra që përmenden 2.5 milionë, 7 milionë, po kemi ndoshta edhe afër 100 milionë apo 200 milionë shpenzime që kanë për të na kushtuar, e ky është problemi me numrin personal. Qytetarët e Kosovës si tatimpagues, por edhe ne si deputetë dhe të gjithë të shërbimit civilë si kontributdhënës të paguajmë me numrin personal të UNMIK-ut dhe i kemi këto edhe me administratën tatimore, edhe problematika tjetër që i nxjerrë të gjithë qytetarët e Kosovës me ndryshimin e numrit personal. Numri personal për *acquis communautaire* apo për objektivat që ne duhet të shkojmë drejt BE-së, standard është me 13 numra. Ne kemi një numër personal dhjetë shifror dhe bëhet një shkelje e madhe ligjore dhe për t'u ndryshuar ky numër dihet, dihet sa janë shpenzimet që mund të nxjerrin Ministrinë, po edhe vetë Qeverinë, edhe vetë Buxhetin e Kosovës përfundimisht para një akti të kryer.

Më erdhi shumë mirë që deputetja, kolegja ime Vezira Emrush shqetësohet për komunitetet tjera. Unë nuk e di a ka pasaportë të Republikës së Kosovës, por kam dëshirë që ta përdorë edhe atë pasaportë kur të dalë jashtë vendit, se po shqetësohet shumë për komunitetin turk. Besoj se ne si Kuvend duhet t'i hapim sytë shumë kur të dalim dhe në aspekt t'i harmonizojmë me ligjet që edhe në atë pjesë ku janë komunitetet tjera pakicë, në qoftë se është e rregulluar ashtu me ligj, të ketë përmbajtje ligjore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Nekibe Kelmendi, pas saj e merr fjalën Ramadan Avdiu.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje kolegë deputetë dhe ju ministra!

Një pjesë të diskutimit tim që ka të bëjë, që lidhet me nenin 6, paragrafi 2, e tha deputeti Riza Smaka, por unë do të ndalesha prapë në këtë nen që lidhet me pikën 14.2.16 ku thuhet "Autoriteti i lëshimit". Ju kisha lutur që të përdoret termi adekuat "organi që e lëshon dokumentin e udhëtimit", sepse autoriteti ka një kuptim më të gjerë dhe nuk mund të futet si nocion ligjor në ligje. Pastaj, në vend të fjalës "formularët dhe dokumentet e udhëtimit të pa personalizuar" të përdoret një term i kuptueshëm, sepse vërtet është e paqartë kjo çka nënkuptohet me fjalën e "pa personalizuar". Kjo lidhet me nenin 7 të këtij projektligji.

Pastaj, neni 8 i Projektligjit, këtu thuhet se "Libreza detare lëshohet në afat vlefshmërie prej dy vitesh". Do të ishte më e preferuar dhe konstruktiv i fjalisë do të dukej më i mirë dhe më e kuptueshme kjo dispozitë nëse thuhet: "Libreza e lëshuar detare ka validitet juridik prej 2 vjetësh, duke llogaritur nga data e lëshimit".

Dhe, në fund, meqë ka vërejtje nga BE-ja se tani nuk duhet të ngutemi me lëshimin e pasaportave biometrike, megjithatë ne dëshirojmë ta kemi një ligj, atëherë nenit 13 kisha propozuar t'i shtohet edhe një paragraf, ku të thuhet: "Ky ligj fillon të zbatohet pas regjistrimit civil". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi!

NEKIBE KELMENDI: Përndryshe, gjurmët e gishtërinjve, ajo duhet të mbetet ashtu si është, sepse ato fitohen me lindje, çdo moment, në momentin e lindjes çdokush i ka gjurmët e gishtërinjve.

KRYESUESI: Ramadan, më fal, zonja Vujoviq më ka lutur, e do fjalën vetëm për gjysmë minute, sepse ka për të shkuar diku. E merr fjalën Radmilla Vujoviq.

RADMILA VUJOVIĆ: Hvala vam puno! Ja se izvinjavam što kršim u startu pravila, negde sam osma možda po redu za glas i da kažem nešto. Ja imam samo dopunu na diskusiju našeg šefa Parlamentarne grupe, gospodina Petra Miletića, kada je reč o jeziku, da svi zakoni i u Parlamentu i u Vladi imaju i moraju da imaju zakonodavnu inspekciju, kako ne bi bilo onih grešaka koje idu na štetu zakona. Tako da ta faza treba da postoji i ona se zove Zakonodavna jezička inspekcija. Ja mislim da ni Vlada, ni Skupština nema. Lektor nije stručnjak da, kada su u pitanju stručni termini, adekvatno prevode i onda dolazi do gubljenja i smisla zakona, a da ne pričamo o funkcionalnosti. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr deputeti Ramadan Avdiu, pas tij të përgatitet Gani Buçinca.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Ndonëse atë çka kisha ndërmend të them u konsumua dhe u dhanë disa sqarime edhe nga ministri dhe nga disa kolegë deputetë, mirëpo unë vetëm desha të theksoj rëndësinë e këtij ligji dhe të sqaroj më tepër jo deputetët, por më tepër opinionin publik për shkak se disa diskutues u përpoqën të krijojnë njëfarë konfuzioni dhe njëfarë paqartësie lidhur me këtë ligj në opinionin publik.

Dua të theksoj se ligji është i domosdoshëm dhe aprovimi i ligjit nuk do të thotë se nuk respektohet rekomandimi i Bashkimit Evropian që lëshimi i pasaportave biometrike të fillojë pas kompletimit të regjistrave civilë, por kjo nuk është pengesë që të aprovohet ligji dhe të respektohet, të krijohet korniza ligjore, sepse gjithmonë ka pasur vërejtje edhe nga qytetarët, edhe nga kolegët deputetë të opozitës – pse nuk punohet në drejtim të përgatitjes së rregullativës, përgatitjes së kornizës ligjore për lëshimin e pasaportave biometrike dhe tash e vënë dilemën pse po bëhen pasaportat biometrike. Kjo është e domosdoshme dhe është një kriter të cilin patjetër ne duhet ta plotësojmë. Ligji është i mirë dhe nuk do të thotë që disa gabime drejtshkrimore e cenojnë substancën e këtij ligji, të cilin edhe unë si shumica absolute e deputetëve e mbështes pa rezervë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ramadan! Fjalën e ka Gani Buçinca, le të përgatitet Synavere Rysha.

GANI BUÇINCA: Ju falënderoj, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë,

Vërtet është bërë si zakon në këtë Kuvend që sa herë të merr iniciativë Qeveria për të përshpejtuar disa procese, nga opozita anatemohehet dhe gjenden fjalë dhe mundohen njerëzit të shpikin lloj-lloj argumentesh për të kundërshtuar një nismë, një iniciativë që është në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kështu ndodh edhe sot, mirëpo unë desha t'i njoftoj qytetarët e Kosovës se janë po këta opozitarë të cilët atëherë kur u përgatit pasaporta jo biometrike, bënë shumë zhurmë dhe hedhën shumë baltë dhe gurë mbi Qeverinë pse nuk e ka përgatitur automatikisht pasaportën biometrike. Dhe tash po del se pasaporta biometrike në ato rrethana, në atë kontekst historik kur është përgatitur, kur është shpallur pavarësia, ka qenë krejtësisht e pamundur dhe tani këta thonë, atëherë thoshin – pse nuk e keni përgatitur, tani thonë – pse ju e bëni pasaportën biometrike. Domethënë, këtu këta duhet t'i pastrojnë gjërat me vetveten, me etikën dhe moralin e vet, t'u tregojnë qytetarëve – gënjenin atëherë apo gënjejnë tash kur flasin. Kjo është një çështje që desha ta shtroj.

Agjenda e Evropës për integrimin e Kosovës në gjirin e vet sigurisht nuk është agjendë që përputhet me synimet tona që ne i kemi që sa më shpejt të integrohemi në Bashkimin Evropian dhe së këndejmi unë e mbështes nismën e Qeverisë për përgatitjen e pasaportës biometrike, që në momentin kur ne të jemi të gatshëm për lëshimin e këtyre pasaportave, të startojmë me lëshimin e këtyre pasaportave.

Pastaj, u dhanë këtu edhe disa shpjegime lidhur me atë se gjëja qytetarët do të kenë shpenzime, meqë i kanë pasaportat e prodhuara më herët. U tha se me pasaportat biometrike do të pajisen vetëm ata qytetarë të cilët kanë interes të udhëtojnë në shtetet e Bashkimit Evropian, kurse ato të vjetrat mund të shfrytëzohen normalisht. Desha të shpjegoj edhe diçka për qytetarët e Kosovës. Qeveria aktuale, koalicioni aktual qeverisës ka gjetur para rreth 1 miliard para për projekte kapitale nacionale dhe nuk është problem për këtë koalicion qeverisës që t'i gjejë 2-3 milionë euro për prodhimin e pasaportave biometrike, kështu që shqetësimet e opozitës janë krejt të pabazuara dhe më shumë kanë për qëllim frikësimin dhe demoralizimin e qytetarëve se sa janë për interesat e qytetarëve të Kosovës. Ju falënderoj, zoti kryesues, ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen!

KRYESUESI: Fjalën e merr Synavere Rysha, të përgatitet Bujar Dugolli.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vërtet do të doja që të ishte prezent edhe ministri deri sa e trajtojmë këtë çështje sepse është një çështje mjaft e rëndësishme dhe vërtet duhet të jetë dhe t'i marrë edhe sugjerimet e deputetëve, sepse për derisa nuk po konsultohemi dhe nuk po pyetemi, po kemi vështirësi dhe dështime të vazhdueshme dhe, thjeshtë, përgjegjësia po mbetet dhe fajti po mbetet jetim.

Unë nuk do t'i referohem diskutimit të kolegut Gani Buçinca, që e tha më herët rreth mungesës së buxhetit, megjithatë jam pak sa më e thirrur dhe më në profesion dhe e kisha orientimin pikërisht te mungesa e buxhetit. Ministri e tha dhe e sqaroj se pasaportat biometrike do të jenë kërkesë e jashtëzakonshme për qytetarët e Kosovës dhe do të mbushet buxheti për të pasur sasi të mjaftueshme të pasaportave. Një qasje totalisht e gabuar.

Megjithatë, unë nuk do të lëshohem në këtë, sepse ministri mban përgjegjësi për fjalën e vet. Si do që të jetë, qytetarët e Kosovës kanë nevojë fillimisht për pasaporta, e mandej do të paguajnë çmimin e tyre. Dhe si duhet kjo, duhet të kemi një buxhet rezerv për sigurimin e këtyre pasaportave.

Këtu në projektligj thuhet se pasaportat biometrike apo buxheti 2.5 milionë që do të sigurohet për vitin 2010, do të sigurohet nga pozicioni i mallrave dhe shërbimeve. Ne hiq më larg se në seancën e radhës do ta kemi shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin apo rishikimin e buxhetit. Dhe u mundova, fatmirësisht që e kisha me vete, u mundova tash dhe e shfletova në secilën faqe dhe pikërisht janë dy javë kur ky projektligj është hartuar dhe nuk janë paraparë. A ka kuptim kjo, e pyes ministrin? Dhe e pyes edhe kolegun Buçinca – nëse vërtet ne si deputetë nuk kemi nevojë t'i japim formën e ligjit parasë publike, atëherë pse po e miratojmë Projektligjin për buxhetin. Ose, e kundërta – pse kemi nevojë të vlerësojmë ndikimet buxhetore në projektligj, kur po mundka ministri t'i sigurojë prej çfarëdo mënyre, prej çfarëdo fondi apo mundet të punojë sepse janë paratë e veta, është shtëpia e vet dhe e menaxhon mënyrën qysh atij t'i teket, kur të dojë i kalon te pasaportat, kur të dojë i kalon te një pozicion tjetër dhe kjo vërtet është shqetësuese për neve si qytetarë, sepse është bërë një praktikë e keqe, me buxhetin po luhet dhe atë në mënyrën më të keqe të mundshme. Ka mundësi buxheti të rishikohet për 10% deri në 20%, por jo mbi 50% të ndryshojnë projeksionet buxhetore, sepse aty po vërehen ndikimet e qeverisë dhe refleksionet e qeverisë apo qasja ku qeveria po ka dëshirë të investojë dhe të tërheq investime për nevoja më tepër ndoshta personale, sesa për interesin e qytetarit.

Ky është një shqetësim dhe unë këtë shqetësim e ngrejë duke pasur parasysh, sepse kemi pasur situatën kur kemi ndërruar pasaportat apo dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut dhe i kemi shndërruar në dokumente të Republikës së Kosovës dhe ajo periudhë e ka gjetur Qeverinë e Kosovës me 300 copë dokumente të udhëtimit apo 300 copë dokumente të UNMIK-ut që kanë mbetur dhe është dashur me muaj të tërë qytetarët tanë, sidomos ata nga diaspora, të presin për t'u pajisur me dokumentet e tilla. Për të mos u përsëritur një situatë e tillë, ne u tërheqim vërejtjen – kujdes më të madh me buxhetin! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Gani Buçinca e ka të drejtën, por unë të kisha lutur shkurt Gani se s'keni objekt, veç nëse doni të shtyheni me fjalë.

GANI BUÇINCA: Pikërisht, i nderuar zoti kryesues, pikërisht desha jo të replikoj, por të njoftoj opinionin që nuk dua të futem në debat me kolegen e nderuar, se e konsideroj krejtësisht absurde dhe të pakuptimtë të humb kohë për ato gjëra.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bujar Dugolli, të përgatitet Driton Tali, që është i fundit.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Ju të pranishëm,

U elaborua bukur mirë nga folësit çështja e këtij ndryshim-plotësimi të Ligjit për dokumentet e udhëtimit. Shqetësimet që i kam unë, janë konsideroj unë edhe shqetësime të shumë qytetarëve, të cilët nuk kanë informacione të duhura sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Çështja e këtij ligji, i cili rregullon çështjen e nxjerrjes së pasaportave biometrike, është një çështje teknike që kurdoherë duhet të ndodhë, është mirë që po ndodh tani, por mendoj që edhe për Ministrinë, edhe për Qeverinë e Kosovës janë disa sfida dhe duhet të jenë disa koordinime të veprimeve për të mos ardhur deri te problemet që mund të shfaqen në këtë proces, se çështja e liberalizimit të vizave nuk është çështje vetëm e pasaportave biometrike.

Konsideroj se ne ende nuk kemi një udhërrëfyes për liberalizimin e vizave për t'i ditur hapat që duhet t'i marrë Qeveria, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme para se të fillojë nxjerrjen e këtyre dokumenteve.

Është krijuar një huti në opinion, që mendoj ende ne nuk kemi marrë një përgjigje të saktë edhe nga Ministria, edhe nga Qeveria se a ndërlidhet çështja e liberalizimit të vizave me çështjen e regjistrimit të popullsisë apo me përmirësimin e regjistrit civil. U dha shpjegim për çështjen e regjistrit civil, po unë konsideroj që regjistrimi i popullsisë mund të jetë një çështje që do të hapet ndërkohë dhe në rast se hapet ndërkohë, a janë bërë këto koordinime të veprimeve si duhet në mes Qeverisë dhe institucioneve ndërkombëtare, në këtë rast të Bashkimit Evropian, që të mos prodhojmë dokumente që mund të kontestohen dhe mund t'i shkaktohet dëm buxhetit.

Ne s'kemi vuajtur për mos pasje të dokumentit, kemi pasur dokumente të UNMIK-ut, që janë quajtur taravel dokument, tash kemi pasaporta të rregullta, pasaporta zyrtare, madje edhe ato diplomatike, po në aspekt me lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe të zyrtarëve të Kosovës nuk paraqesin asgjë përveç një elementi identifikimi, i cili do t'i nënshtrohet çdo procedure tjetër, si çdo qytetar tjetër, domethënë nuk ka kurrfarë përparësie. Thjeshtë, liberalizimi i vizave unë konsideroj që është proces i komplikuar dhe pa pasur një udhërrëfyes i cili është premtuar që do të jetë edhe kryeministri sot e tha, konsideroj që mos të bëhen hapa të ngutshëm që mund t'i kushtojnë buxhetit edhe pritjeve të qytetarëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë po shoh edhe emrin e Vezira Emrush. Ajo ka folur në emër të Grupit, ndoshta flet personalisht, por nuk po e shoh këtu. Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të jesh i fundit, edhe nuk po mbetet fort për t'u thënë diçka, por më ngacmuan fjalimet e fundit dhe në atë kontekst unë ende nuk e kam të qartë pse këta pasaportat biometrikë nuk janë prodhuar me kohë. Edhe ashtu pasaportat lëshohen për afat shumë vite dhe deri sa ato të kishin skaduar, shumë gjëra kishim për t'i rregulluar. Tash, mbase mediat kishin të drejtë që më shumë aluduan apo trumbetuan në atë se dikush e keqmenaxhoi atë tenderin prej 5 milionë, nëse nuk gaboj, ka qenë vlera dhe tash të jepen edhe disa të tjera. Unë me të vërtetë nuk e kam të qartë këtë.

Përndryshe, pata të flas diçka edhe sa i përket ligjit, projektligjit në realitet, por ato veç u thanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash nuk ka më diskutues të tjerë. Në sallë kemi 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të bëhemi gati dhe ta votojmë në lexim të parë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit. Regjia, gati, votojmë tash!

Ju lutem, kush është “për”, që është pa kartelë me vete? 1 “për”. Domethënë, me 60 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, votohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Punë të brendshme dhe Siguri, si komision funksional, dhe
- Komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, t'ia paraqesin raportet me rekomandime këtij Kuvendi.

Kalojmë në pikën e gjashtë:

6. Votimi i Kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarë të Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen plenare të mbajtur më 17 qershor 2010, mirëpo për shkak të mungesës së kuorumit për të votuar, kjo pikë është proceduar për votim në mbledhjen e sotme.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e kërkesës për lejimin e kompensimit për anëtarë të Bordit dhe personelit administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Bëhuni gati, regjia dhe deputetë, votojmë tash!

Kush është “për” pa kartelë? Janë 2. Me 34 vota “për”, 25 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Kërkesën për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Pika e shtatë është:

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e natyrës

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e natyrës, të miratuar në parim në Kuvend, më 31 maj 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky ligj t'i kthehet Qeverisë, për ripunim.

Kryetari i komisionit, Naser Rugova, apo raportuesi i komisionit për arsyetimin e këtij raporti me rekomandimet për Kuvendin. Zoti Rugova, urdhëroni!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në mbledhjen plenare të datës 31.5.2010, është shqyrtuar dhe miratuar në leximin e parë Projektligji për mbrojtjen e natyrës, i cili përmbante 208 nene. Ndërkohë, në Kuvend ka ardhur draftligji nga ana e Qeverisë me një version tjetër me 177 nene.

Për hir të korrektësisë, respektimit të ligjshmërisë, Rregullores së Punës të Kuvendit dhe procedurave parlamentare, komisioni ka vendosur që ta kthejë prapa.

Është një ligj i nevojshëm dhe me këtë vendim besoj se do të hapet rruga që ky projektligj të vjen sa më parë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem, unë mendoj se mund të thërras një nga një grupet të deklarohe, por unë megjithatë e qes në votim mendimin e komisionit. Kush është për, le të votojnë deputetët. Pra, regjia dhe deputetë, bëhuni gati, votojmë tash!

Ju lutem, kush është “për” pa kartelë? 2. Kemi 52 vota “për”, 7 “kundër”, 4 abstenime dhe konstatoj se Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që Projektligji për mbrojtjen e natyrës t'i kthehet Qeverisë, për ripunim.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative, të miratuar në parim në Kuvend, më 11 mars 2010, dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky ligj t'i kthehet Qeverisë, për ripunim.

Kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Esat Brajshori e ka fjalën. Urdhëroni!

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Kabinet qeveritar,

Siç tha edhe kryesuesi dhe siç e keni në rekomandim, komisioni ynë e ka shqyrtuar këtë projektligj, e ka punuar me seriozitetin më të madh dhe është mbështetur nga ekspertë të çmuar dhe të vlerësuar shumë dhe ka gjetur se ky projektligj ka mangësi të mëdha.

Unë jam tani këtu i obliguar që të them se në projektligjin për të cilin po flasim, nuk janë përfshirë këto çështje:

- ndihma juridike në procedurën administrative;
- pala dhe përfaqësimi i saj;
- komunikimi i organeve dhe palëve;
- thirrja;
- procesverbali.

Do të thotë këto janë mungesat kyçe;

- këqyrja e shkresave dhe informimi mbi rrjedhën e procedurës;
- dërgimi i shkresave;
- afatet;
- mbrojtja e rendit në procedurë;
- shpenzimet e procedurës;
- procedura e shkurtër e shqyrtimit;
- procedura e veçantë e shqyrtimit;
- seanca verbale.

Ajo që është mungesë e madhe në këtë projektligj, ka të bëjë me:

- mjetet e provës;
- dokumentet;
- dëshmitarët;
- ekspertimi;
- këqyrja në vend;
- interpretimet, e tjera.

Një mangësi tjetër në këtë projektligj është:

- mungesa e vendimit të pjesshëm, plotësues dhe të përkohshëm;
- procedurat sipas kërkesës.

Dhe, ajo çka është mungesë tepër e madhe, është:

- mungesa e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, dhe
- ekzekutimi administrativ.

Vlen të përmendet se të gjitha shtetet e rajonit i kanë mjetet e jashtëzakonshme juridike të përfshira në projektligjet ose ligjet e tyre për procedurën administrative.

Komisioni, për të ardhur deri te një harmonizim me sponzorizuesin, ka ftuar dy herë radhazi përfaqësuesit e administratës dhe e kemi shqyrtuar bashkërisht Projektligjin, të cilët përfaqësues kanë pohuar se disa nga vërejtjet e komisionit tonë janë të qëndrueshme për këtë projektligj.

Në sajë të kësaj, ne kemi përfunduar si komision që projektligji t'i kthehet sponzorizuesit. Ndryshe, komisioni ka punuar mbi bazën e kësaj substance aktuale që ka sjell sponzorizuesi 56 amendamente dhe e ka punuar rishtazi ligjin me këto mangësi që i përmenda më herët, në mënyrë që të bëhet një ligj

sa më i mirë. Por, meqë kalon 40% kur ndërhyhet në raste të tilla, më mirë i ka preferuar seancës që ta kthejë te sponsori.

Edhe një herë potencoj: Komisioni, mbi bazën e materialit që na ka ardhur, i ka punuar 56 amendamente dhe e ka punuar ligjin në tërësi, me këto mangësi. Thërras seancën që ta kthejë prapa këtë projektligj, te sponsorizuesi.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju thërras të bëhemi gati ta votojmë rekomandimin e komisionit.

Në sallë kemi 70 deputetë. Regjia dhe deputetë, bëhuni gati, votojmë tash:

Kush është “për” e që nuk ka kartelë? 2 janë “për” pa kartelë. 56 dhe 2 bëjnë 58 “për”, 3 janë “kundër” dhe 5 abstenime.

Ju njoftoj se Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative t’i kthehet Qeverisë, për ripunim.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimin e anëtarëve për Bordin për Ankesa të Mediave nga Gjykata Supreme e Kosovës

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për mos miratim.

Kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Esat Brajshori, do të japë arsyetimin për raportin me rekomandimet. Urdhëroni, zoti Brajshori!

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë, përshëndetje për të gjithë!

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional, me datën 12 mars 2010 ka pranuar shkresën nga Komisioni i Pavarur për Media, në të cilën shkresë thuhet se KPM-ja ka pranuar dy emrat e përzgjedhur për anëtarë të Bordit të Ankesave për Media nga Gjykata Supreme. Përmes kësaj shkrese KPM-ja vë në dijeni se kandidatja zonja Fllanza Kadiu paraqet konflikt interesi për këtë post, sepse një nga anëtarët e saj të familjes së ngushtë, motra e saj, ka pozitë menaxheriale në transmetuesin publik të Kosovës, në Radiotelevizionin e Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, më 26 mars 2010, i është drejtuar Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi me shkresën për t’u deklaruar se a paraqet konflikt interesi propozimi i kandidates nga Gjykata Supreme e Kosovës për anëtare të Bordit për Ankesa për Media.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, lidhur me kërkesën e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka rekomanduar që të veprohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, neni 6 dhe 7 dhe Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, pasi e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi ka konstatuar se kandidatja e propozuar për anëtare të Bordit të Ankesave për Media nga Gjykata Supreme e Kosovës, zonja Fllanza Kadiu, nuk mund të jetë dhe nuk mund të emërohet anëtare e BAM-it për shkak se ekziston konflikti i interesit për ushtrimin e funksionit për të cilin është propozuar, pasi

që motra e saj, Elvane Prekazi, ka pozitë menaxhuese në Radiotelevizionin e Kosovës, andaj Komisioni i rekomandon Kuvendit të Kosovës që mos ta miratojë propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit për arsyetimin, zoti deputet! Unë ju thërras deputetë që ta votojmë rekomandimin e komisionit. Regjia dhe deputetë, votojmë tash:

Pa kartela “për” i kemi 3. Pra, 66 vota janë “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime dhe Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave.

Zotërinj deputetë, kjo seancë mbaroi. Faleminderit për bashkëpunim! Mirupafshim!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës